



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 28 (827780)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 15 Korrik 2022

Gjeneral brigade Bilbil Bitri priti në takim atasheun ushtarak bullgar, kolonel Momchil Ivanov

Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bilbil Bitri, priti atasheun ushtarak të Bullgarisë në Tiranë, kolonel Momchil Ivanov, me rastin e përfundimit të detyrës.

Gjeneral brigade Bitri, pasi i uroi mirëseardhjen, vlerësoi kontributin dhe angazhimin e

kolonel Ivanov në bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes mes Shqipërisë dhe Bullgarisë, bashkëpunim i cili është në rritje.

Përveçse në rrafshin dypalësh, bashkëpunimi me Bullgarinë zhvillohet edhe në kuadër të nismave rajonale dhe të Aleancës dhe roli i atasheut mbetet i rëndësishëm.

Njëherazi gjeneral brigade Bitri i uroi mirëseardhjen atasheut të ri të Bullgarisë në Tiranë, kolonel Miroslav Sandrev.

Gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit shprehën besimin dhe dëshirën e vijimit dhe forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve edhe në të ardhmen... »

faqe 2



NATO, bazë detare në Durrës, Rama i paraqet propozimin Sekretarit të Përgjithshëm Stoltenberg

Kryeministri Rama: Shqipëria, krenare për rolin e saj për paqen dhe stabilitetin



Anija e Forcës Detare franceze "BBPD Pluton M622", vizitë portuale në Portin e Vlorës dhe Durrësit

Fluturak Gërmenji, misionari i kulturës dhe gazetarisë

Promovimi i "Skënderbegasit ndër vite...", volumi i katërt, i Kujtim Boriçit & Maksi Fejzulla, ceremoni mbresëlënëse në Athinë

Anija e Forcës Detare franceze "BBPD Pluton M622" zhvilloi një vizitë portuale në Portin e Vlorës dhe Durrësit. Vizita kishte në fokus forcimin dhe bashkëpunimin midis Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare franceze duke rritur shkallën e ndërveprimit përmes operacioneve në kuadrin e angazhimeve të përbashkëta në NATO. Gjatë kësaj vizite portuale, personeli i Qendrës së Zhytjes së Forcës Detare në bashkëpunim me anijen franceze...



» faqe 2

Kolonel Fluturak Gërmenji, ushtaraku dhe gazetari i gazetës "Ushtria", i ndarë nga jeta fizikisht por me një jetë të përkushtuar penës dhe uniformës ushtarake, mbetet një figurë e rëndësishme për FA-të dhe jo vetëm. Lindur më 21 nëntor 1948 në Tiranë. Studioi në Shkollën Ushtarake "Skënderbej" dhe më pas në Fakultetin e Gjuhë-Letërsisë Shqipe. Në vitin 1971 - 1975 punoi si shef i Kulturës dhe Propagandës në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve. Në vitet 1976 - 1981 punoi në ishullin e Sazanit, në Kompaninë AKA IMKA-4, Bat. AKA dhe Aparatin e KP të ishullit...



» faqe 6

Në mjediset e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në kryeqytetin helenas u realizua promovimi i pjesës së katërt të kolanës "Skënderbegasit ndër vite...", i autorëve Kujtim Boriçi e Maksi Fejzulla. Aktiviteti u zhvillua me mbështetjen e Ambasadores Luella Hajdaraga, me angazhimin e Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë, degës së saj në Athinë dhe shtëpisë botuese "Enja". Në këtë aktivitet, mermin pjesë ushtarakë në lirim në Greqi, shkrimtarë, poetë publicistë shqiptar me banim në shtetin fqinj dhe vendas, kolegë të autorëve etj...Të pranishëm gjithashtu ishin Kolonel... »



» faqe 7

Shtabi i Përgjithshëm

Gjeneral brigade Bilbil Bitri priti
në takim atasheun ushtarak bullgar,
kolonel Momchil Ivanov

Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bilbil Bitri, priti atasheun ushtarak të Bullgarisë në Tiranë, kolonel Momchil Ivanov, me rastin e përfundimit të detyrës.

Gjeneral brigade Bitri, pasi i uroi mirëseardhjen, vlerësoi kontributin dhe angazhimin e kolonel Ivanov në bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes mes Shqipërisë dhe Bullgarisë, bashkëpunim i cili është në rritje.

Përveçse në rrafshin dypalësh, bashkëpunimi me Bullgarinë zhvillohet edhe në kuadër të nismave rajonale dhe të Aleancës dhe roli i atasheut mbetet i rëndësishëm.

Njëherazi gjeneral brigade Bitri i uroi mirëseardhjen atasheut të ri të Bullgarisë në Tiranë, kolonel Miroslav Sandrev.

Gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit shprehën besimin dhe dëshirën e vijimit dhe forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve edhe në të ardhmen.

Forca Detare vizitohet nga përfaqësues të Akademisë
së Detarisë së Forcave Detare të Rumanisë

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra priti në një takim kortezie Komandantin e Akademisë së Forcave Detare të Rumanisë kapiten i rangut I Alecu TOMA. Kundëradmiral Agastra i uroi mirëseardhjen në Komandën e Forcës Detare dhe shprehu konsideratat e tij mbi bashkëpunimin me Forcën Detare të Rumanisë.

Kapiten i Rangut I Alecu TOMA falënderoi për mikpritjen dhe shprehu konsideratat e tij për angazhimin që Forca Detare shqiptare ka pasur në bashkëpunimin e deritanishëm midis dy institucioneve.

Gjatë takimit, u shkëmbyen opinione mbi funksionimin e sistemit të edukimit dhe të trajnimit në vendet respektive. Gjithashtu u shkëmbyen ide mbi bashkëpunimin midis dy Forcave Detare në fushën e trajnimit dhe të edukimit të personelit. Takimi kaloi në një frymë të ngrohtë miqësore dhe në përfundim, të dy palët u dakordësuan mbi rritjen e nivelit të bashkëpunimit ushtarak në të ardhmen si dhe u shkëmbyen



dhurata zyrtare.

Më tej, u zhvilluan bisedime të përbashkëta midis dy delegacioneve mbi organizimin, strukturën, sistemin e edukimit dhe të trajnimit në Forcat Detare respektive si dhe fushat e bashkëpunimit për të ardhmen.

FORCA DETARE

Anija e Forcës Detare franceze
“BBPD Pluton M622”, vizitë portuale
në Portin e Vlorës dhe Durrësit

Anija e Forcës Detare franceze “BBPD Pluton M622” zhvilloi një vizitë portuale në Portin e Vlorës dhe Durrësit. Vizita kishte në fokus forcimin dhe bashkëpunimin midis Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare franceze duke rritur shkallën e ndërveprimit përmes operacioneve në kuadrin e angazhimeve të përbashkëta në NATO. Gjatë kësaj vizite portuale, personeli i Qendrës së Zhytjes së Forcës Detare në bashkëpunim me anijen franceze, zhvilluan operacionin për heqjen e predhave në Gjirin e Vlorës. Operacioni kishte për qëllim rritjen e sigurisë për përdoruesit e detit në Gjirin e Vlorës.

Personeli i anijes franceze zhvilloi gjithashtu edhe një vizitë kulturore në Muzeun Historik Kombëtar të Krujës.



NATO, bazë detare në Durrës, Rama i paraqet propozimin Sekretarit të Përgjithshëm Stoltenberg

Idenë e tij për vendosjen e një baze ushtarake të NATO-s në portin e ri të Durrësit, kryeministri Rama ia prezantoi dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Aleancës, Jens Stoltenberg, me të cilin zhvilloi një takim zyrtar në Bruksel.

Në konferencën për mediat me Stoltenberg, kryeministri Rama tha se Shqipëria është krenare për rolin e saj në rajon.

“Është kënaqësi e madhe dhe po kështu një nder që kthehem këtu dhe që kam mundësinë të ndaj me ju disa opinione pas samitit të Madridit, i cili, siç e theksuat, ishte vërtetë një moment historik për Aleancën Transatlantike në përgjigje ndaj rreziqeve të sigurisë europiane për shkak të luftës së qëllim të Rusisë e po kështu dhe me miratimin e vendimeve të rëndësishme për të transformuar dhe forcuar Aleancën dhe për të siguruar që NATO të vijojë të mbrojë paqen dhe të parandalojë konfliktin e të mbrojë popujt dhe vlerat e Aleancës.

Nga ana tjetër, jam krenar që Parlamenti Shqiptar u bë një prej parlamenteve të para të vendeve aleate për të ratifikuar protokollet e anëtarësimit të Finlandës dhe Suedisë, vetëm pak ditë pas nënshkrimit të tyre nga ambasadorët e vendeve aleate. Ne qëndrojmë me forcë në solidaritet të plotë me Ukrainën dhe sigurisht që është e padiskutueshme mbështetja jonë për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës, brenda kufijve të njohur ndërkombëtarisht, mbështetje që është më e palëkundur se kurrë.

Nga ana tjetër, është e rëndësishme që ne të vazhdojmë bashkëbisedimin tonë përkundrejt situatës dhe po kështu edhe detyrimet që ne kemi në Ballkanin Perëndimor, që pikërisht të parandalojmë çdo përshkallëzim e të parandalojmë që çdo ndikim i keq të kthehet në problem për rajonin tonë. Në kapacitetin tonë si vend aleat dhe si vend kandidat për në BE, ne do vazhdojmë të luajmë rolin tonë tradicional, në mbështetje të paqes rajonale, pajtimit dhe sigurisë, stabilitetit.

Ndërkohë që koncepti i ri strategjik që sapo kemi miratuar thekson rolin strategjik të Ballkanit Perëndimor për NATO-n, ne besojmë shumë se është tejet e rëndësishme që të vijojmë një

Kryeministri Rama: Shqipëria, krenare për rolin e saj për paqen dhe stabilitetin



dialog të përhershëm me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Serbinë, e cila nuk është pjesë e aleancës sonë, por ende është pjesë e rajonit tonë.

Nga ana tjetër, pata dhe njëherë shansin t’ju them atë që kam përmendur tashmë në Samit. Nevojën për të konsideruar përfshirjen e Kosovës

në partneritetin për paqe edhe pse e dimë që ka disa kufizime politike nga disa aleatë dhe e dimë që ky është organizëm konsensual. Megjithatë, në kohët ku jetojmë, në këndvështrimin tim modest, është vërtetë e mençur që kjo të ri konsiderohet. Së fundmi në radhë, por jo nga rëndësia, e vlerësoj shumë disponibilitetin tuaj për të na

kushtuar pak kohë në bisedën tonë për t’ju prezantuar ambicien tonë, për të shtuar një vlerë tjetër të rëndësishme në infrastrukturën dhe logjistikën e aleancës sonë, duke vënë në dispozicion të NATO-s një bazë të flotës detare të fjalës së fundit që do të jetë një vend që jo vetëm mund të ndërtojë, por mund ta ndërtojë

duke pasur parasysh sfidat e kohës sonë, nga ndryshimi i klimës, nga mbrojtja e mjedisit e gjithçka tjetër. Faleminderit shumë edhe për këtë dhe është përherë kënaqësi të kthehesh këtu dhe është gjithnjë e dobishme të kthehesh me energji të plota e të vazhdosh t’i shërbesh kësaj aleance të shenjtë”, -tha Rama.

Komandanti i Forcës Ajrore priti në takim kortezie atasheun ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar

Në mjediset e Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj priti në një takim kortezie atasheun ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar për Shqipërinë dhe Malin e Zi, nënkolonel Timothy Wight-Boycott.

Gjeneral Pulaj e falënderoi atasheun për kontributet që Mbretëria e Bashkuar ka dhënë për Forcën Ajrore të RSH në të kaluarën, konkretisht për trajnimin e 12 pilotëve në kursin “Type Rating” dhe 4 efektivave në kursin për operacionet “SAR”, si dhe kryerjen e kursit “Royal Air Force Accademy” nga ana e toger Kidir Sakti. Gjithashtu, ai vlerësoi bashkëpunimet e frytshme në stërvitjet “Albanian Lion” dhe “Ballkan Lion”, ku theksi u vu në shkëmbimin e eksperiencës dhe ndërvëprimin e suksesshëm midis dy palëve. Në vijim të fjalës së tij, gjeneral brigade Pulaj u shpreh i hapur për bashkëpunimin e mëtejshëm ne drejtimit të trajnimit dhe stërvitjeve me palën angleze, veçanërisht në trajnimin e pilotëve dhe teknikëve për marrjen e orëve të fluturimit si dhe krijimin e mundësisë për pjesëmarrje në kursin “Royal Air Force Accademy”.

Forca **AJRORE**

Nga ana e tij, nënkolonel Boycott e siguroi se është i hapur për rritjen e bashkëpunimit në fushat e mësipërme, sidomos në synimet që kanë Forcat e Armatosura në kuadër të përmbushjes së OK-ve. Në vazhdim ai u shpreh se do të përpiqet të mundësojë një program për trajnimin e pilotëve për marrjen e orëve të fluturimit në simulator.

Në përfundim të takimit, gjeneral brigade Pulaj falënderoi atasheun për vizitën e tij në Komandën e Forcës Ajrore dhe i uroi suksese të mëtejshme në detyrë, duke e siguruar se bashkëpunimi do të vazhdojë dhe në të ardhmen.



Komandanti i Forcës Tokësore merr pjesë në Konferencën e Forcave Tokësore Europiane

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në Konferencën e Forcave Tokësore të 37 vendeve të Europës, ushtrisë amerikane dhe Kanadasë. Ky aktivitet, i cili u zhvillua në Gjermani, u organizua dhe drejtua nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Europën dhe Afrikën, me pjesëmarrjen e drejtuesve më të lartë të kësaj komande. Përgjatë tre ditëve të zhvillimit të saj, konferenca u thellua në diskutime mbi një larmi temash siç ishin sfidat aktuale dhe çështjet e sigurisë e gatishmërisë, ndërveprueshmërisë mes aleatëve dhe partnerëve, si dhe projektet e ardhshme të modernizimit të mëtejshëm, për mbrojtjen dhe sigurinë e përbashkët. Konferenca e Forcave Tokësore europiane, shërbeu për rritjen dhe thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit reciprok, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.



Në Fort Drum, New York, 47 efektivë të batalionit të Dytë të Këmbëorisë së Forcës Tokësore, zhvilluan stërvitjen “eXportable Combat Training Capability”, së bashku me Brigadën e 44-të të këmbëorisë, Grupin e 42-të Mbështetës Rajonal në kuadër të partneritetit me Gardën Kombëtare të New Jersey-it.



Me përfundimin e testimeve, këtë fundjavë ushtarët e rinj që po trajnohen në repartet e Forcës Tokësore, mbyllen me sukses fazën Blu të Stërvitjes Individuale të Avancuar



Batalioni i Mbështetjes me Luftim, teston kapacitetet për Emergjencat Civile





Gjeneral brigade Xhebexhia uroi dhe përgëzoi efektivat EOD për kontributin e çmuar, dhënë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (enhanced Forward Presence - eFP) të NATO-s në Letoni si pjesë e kontributit të FA në përbërje të Aleancës.

Në mjediset e Batalionit të Xhenios u zhvillua ceremonia e ardhjes së Kontingjentit X EOD nga Letonia.

Në këtë ceremoni mori pjesë komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia.

Komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mëhillaj falënderoi gjeneralin për praninë e tij në këtë ceremoni si dhe shprehu mirënjohje për punën e bërë nga efektivi i Kontingjentit X.

Gjeneral brigade Xhebexhia uroi dhe përgëzoi efektivat EOD për kontributin e çmuar, dhënë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (enhanced Forward Presence - eFP) të NATO-s në Letoni si pjesë e kontributit të FA në përbërje të Aleancës.

Ai vuri në dukje punën, përkushtimin e profesionalizmin e treguar në realizimin me sukses të detyrës jashtë vendit si dhe i siguroi të pranishmit për mbështetjen që do të kenë nga Komanda Mbështetëse në realizimin e detyrave të tyre.

Ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët.



Specialistët EOD realizojnë eliminimin dhe nxjerrjen nga thellësia e detit të municioneve të paplasura

Pesë specialistë EOD të Batalionit të Xhenios, në Komandën Mbështetëse, të shoqëruar dhe nga Policia Ushtarake realizuan me sukses asgjësimin e një mine të Luftës II Botërore, tip PP minsr.

Me gjithë terrenin e disfavorshëm ata arritën ta identifikonin dhe krijonin kushtet për asgjësimin e saj me plasje elektrike.

Operacioni është kryer me sukses konform rregullave të sigurimit teknik

Po kështu, në qytetin e Vlorës, tek ujërat në vendin e quajtur “Kalaja”, shtatë efektivë EOD me 2 mjete të Batalionit të Xhenios kanë zhvilluar një operacion për nxjerrjen e municioneve nga thellësia e detit.

Operacioni u realizua në bashkëpunim me zhytësit shqiptarë të Pashalimanit dhe ata francezë. Komandanti i operacionit EOD, kapiten Roland Hysa, drejtuesit shqiptarë e francezë të zhytësve pas një brifingu që u zhvillua në anijen franceze bashkërenduan



të gjitha veprimet, si ato në thellësi të ujit dhe në sipërfaqe, si edhe pas dy orësh u arrit që të nxirren nga thellësia e detit 85 municione “lifted” të Luftës II Botërore.

Ekipi EOD mbasi bëri vlerësimin, nxorën të dhënat e municioneve dhe kryen veprimet e magazinimit të tyre.

Operacioni përfundoi me sukses.



Xhenierët e Komandës Mbështetëse eliminojnë rrezikun e rënies së shkëmbinjve në pikën e kalimit kufitar Kapshticë

Në pikën e kontrollit të pasagjerëve në doganën e Kapshticës, prej disa kohësh rreziku i rënies së shkëmbinjve ishte evident dhe në çdo moment mund të rrezikohej jeta e udhëtarëve dhe e punonjësve.

Në vazhdim të kontributit të Forcave të Armatosura në ndihmë të komunitetit Kompania e Punimeve Xheniere, në Batalionin e Xhenios, për më se 10 ditë punoi për eliminimin e këtij rreziku.



13 forca, 3 mjete dhe 1 agregat, punuan për largimin e shkëmbinjve, që mund të shpëtohen nga masivi shkëmbor, i cili ndodhej mbi ambientet e doganës.

Për lëvizjen e tyre u punua si me plasje ashtu dhe në mënyrë mekanike. U gërmuan dhe u lëvizën rreth 130 metër kub shkëmb, u mbulua me rrjetë pjesa shkëmbore pranë doganës dhe u pastrua vendi nga inertet.

Të gjitha këto volume pune u kryen në një terren të vështirë e nën një diell përvëlues.

Vlen këtu për t'u përmendur bashkëpunimi me përfaqësuesit e doganës në zgjidhjen e problemeve që dolën gjatë kryerjes së punimeve. Trupat xheniere me këtë operacion treguan se do të jenë përherë pranë komunitetit me kontributin e tyre.



Si misionar i kulturës, poet dhe gazetar përshkroi gjithë Shqipëri-në, takoi, bisedoi dhe krijoi miqësi me shumë njerëz. Mori motive, shkroi, portretizoi dhe u bë një figurë mjaft e dashur dhe e respektuar publike. Si kryeredaktori revistës “10 Korriku”, u shfaq si një krijues dhe reformator i guximshëm.



Misionari i kulturës dhe gazetarisë

Kolonel Fluturak Gërmenji, ushtaraku dhe gazetari i gazetës “Ushtria”, i ndarë nga jeta fizikisht por me një jetë të përkushtuar penës dhe uniformës ushtarake, mbetet një figurë e rëndësishme për FA-të dhe jo vetëm.

Lindur më 21 nëntor 1948 në Tiranë. Studioi në Shkollën Ushtarake “Skënderbej” dhe më pas në Fakultetin e Gjuhë-Letërsisë Shqipe.

Në vitin 1971 - 1975 punoi si shef i Kulturës dhe Propagandës në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve.

Në vitet 1976 - 1981 punoi në ishullin e Sazanit, në Kompaninë AKA IMKA-4, Bat. AKA dhe Aparatin e KP të ishullit të Sazanit.

Në vitet 1981-1983 ka punuar si shef i sektorit të shtypit në Drejtorinë e Kulturës së Ministrisë së Mbrojtjes. Ka qenë anëtar i Redaksisë së Mbrojtjes pranë Akademisë së Shkencave për botimin e Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, botuar në vitin 1985.

Në vitin 1983 u emërua kryeredaktor i revistës ushtarake “10 Korriku”, deri në vitin 1993 drejtoi atë revistë, e cila pas viteve '90 mori titullin “Ushtria dhe Koha”.

Ka përfaqësuar ushtrinë shqiptare në disa prej veprimtarive të organizuara nga NATO në Holandë dhe Greqi.

Nga viti 1997 - 2005 ka qenë Shef i Zyrës së Oborrit Mbretëror Shqiptar.

Ka qenë një prej anëtarëve themelues të Shoqatës së Historianëve Ushtarakë.

Ka botuar reportazhe, tregime, novela, skenarë për filma të Kinostudios dhe TVSH, artikuj historikë në të gjitha organet e shtypit.

Në vitet '70-'80 ka botuar libra me poezi “Korriku Ynë”, “Valë e detit”. Ka marrë disa çmime kombëtare për poezi.

Bashkautor në botimin e tre librave si: “Yje të Pashuar”, kushtuar akteve heroike të dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Gjatë viteve '90 ka botuar libra studimore “Mesazhe Paqe”, “Familja Mbretërore Shqiptare”, “Mbretëresha Suzanë”. Ka redaktuar dhjetëra libra me tregime si dhe ka bashkëpunuar për dokumentarin e Luftës së Kosovës.

Në vitin 2014 botoi librin studimor historik “Misioni Holandez - Koloneli Tomson”.

Në vitin 2015 botoi librin studimor-turistik me fotografi, në shqip dhe anglisht “Sazani i Panjohur”.

Një jetë e mbushur me krijimtari, e cila do pasqyrohet gjerësisht në të gjitha mediat. I tillë ishte koloneli me “penën e artë”, Fluturak Gërmenji, të cilin miqtë e tij do e kujtonin “Lokun”, siç ata e thërrisnin, si një nxënës të shkëlqyer në shkollën “Skënderbej”, si student të zellshëm në Fakultetin e Gjuhë-Letërsisë Shqipe, si një specialist të spikatur të kulturës, si një drejtues dhe kryeredaktor të revistës “10 Korriku”.

Tek “Loku” bashkoheshin në sinkron vlerat njerëzore dhe profesionale. Njeriu fisnik, me zemër të madhe dhe mendje të hapur. Miku i të gjithëve. Fluturak Gërmenji ishte një intelektual me vlera të padiskutueshme, jo vetëm në garnizonet ushtarake, por edhe në mjediset kulturore, artistike të Shqipërisë, ku pena e tij shkëlqen. Punoi për

FLUTURAK GËRMENJI, misionari i kulturës dhe gazetarisë



tre dekada në sektorin e kulturës dhe shtypit dhe u bë misionar i saj.

I realizoi me përsosmëri detyrat e ngarkuara dhe krijoi përvojë që u ndoq nga të tjerët. Me mbarimin e studimeve, vetëm 22-vjeçar, punoi në sektorin e Kulturës e të Propagandës në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe ndihmoi që Shkolla Ushtarake të krijonte fytyrën e saj të dytë, atë të Kulturës dhe studentët, veç edukimit ushtarak, të merrnin dhe edukimin e përgjithshëm

kulturor, për t'u lartësuar në vlera njerëzore dhe si intelektualë. Misionin e tij e vazhdoi në garnizonin më të madh të ushtrisë shqiptare, në ishullin e Sazanit, në një qytezë ushtarake, ku jetonin mijëra ushtarakë, specialistë e familjarët e tyre.

Bashkë me shumë vizionarë të tjerë aktivizoi të rinjtë me veprimtari të shumta kulturore, letrare, artistike e sportive, duke e kthyer qytezën ushtarake edhe në qytezë kulturore.

Në detyrën e drejtuesit të sektorit të Kulturës e të Shtypit në Ministrinë e Mbrojtjes zhvilloi një punë të vlefshme studimore e përgjithësuese për probleme të rëndësishme të kulturës, të edukimit atdhetar dhe të përgatitjes psikologjike të ushtarakëve, të cilat i paraqiti në shumë shkrime në organet e shtypit ushtarak e kombëtar dhe në veprimtari teorike-praktike.

Si misionar i kulturës, poet dhe gazetar përshkroi gjithë Shqipërinë, ta-

koi, bisedoi dhe krijoi miqësi me shumë njerëz. Mori motive, shkroi, portretizoi dhe u bë një figurë mjaft e dashur dhe e respektuar publike.

Si kryeredaktori revistës “10 Korriku”, u shfaq si një krijues dhe reformator i guximshëm. Ai e pasuroi me rubrika dhe tematika interesante, e bëri më sociale, më kulturore dhe më artistike. Pa e cenuar misionin e saj, ngritjen kulturore dhe edukimin atdhetar të ushtarakëve shqiptar.

Revista eci me kohën, u hap dhe u rinovua aq sa u bë i nevojshëm dhe ndryshimi i emrit dhe u quajt “Ushtria dhe Koha”, e cila u bë e ngjashme me shumë simotra të ushtrive perëndimore.

Në muajt e fundit të jetës përfundoi dhe skenarin e dokumentarit për vajzat ushtarake “Ato ishin të parat”, po për vajzat ushtarake ka bërë në vitin 1977 skenarin e dokumentarit. Autor i shumë teksteve të këngëve të kompozuar nga kompozitori Kastriot Gjini.

Pas një burri të suksesshëm qëndron stoike një grua, e tillë është dhe bashkudhëtarja e jetës së koloneli Gërmenji, zonja Luljeta, e cila ndau me lexuesin tonë të ri disa momente nga jeta e bukur dhe plot sfida, siç ishte dhe ajo e cila i ndau nga kjo jetë fizikisht por kurrë shpirtërisht.

Mes vargjeve të mëposhtme të penës së narratorit Fluturak Gërmenji ajo përcolli gjithë mall dhimbjen për humbjen e shokut të saj më të mirë, dhe ne humbjen e një gazetari dhe poeti të vlerë!

Me Helikopter në Sazan Fluturak Gërmenji, Sazan 1992

*Afrohem unë, afroresh ti,
Është mirazh apo e vërtetë?
As unë këtë nuk e di...
As qiell i kaltër, as det i qetë.*

*Një pulëbardhë rri mes nesh,
Si mirëseardhja e tij në prag.
Helikopteri me një buqetë resh,
Me mua buzëqesh nga lart.*

*Ç'po thonë pishat e monopetet?
Kepi i pëllumbave ç'po bën tani?
Mbi to mali shkund petalet,
Prej tyre, tek mua buron poezi!*

*Afrohem unë, afroresh ti,
Si miq që malli i ka marrë!
Në këtë vrap drejt njëri-tjetrit,
Të dy jetojmë rininë e parë.*

I emocionuar dhe mirënjohës, e ndjej për detyrë, që dhe në emër të bashkautorit Maksi Fejzulla, të falënderoj nga zemra të gjithë organizatorët dhe kontribuuesit që mundësuan këtë aktivitet të veçantë në mjediset e Ambasadës së Shqipërisë në Athinë të Greqisë, promovimin e volumit të katërt të kolanës “Skënderbegasit ndër vite...”, Kujtim Boriçi



Promovimi i “Skënderbegasit ndër vite...”, volumi i katërt, i Kujtim Boriçit & Maksi Fejzulla, ceremoni mbresëlënëse në Athinë



Në mjediset e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në kryeqytetin helenas u realizua promovimi i pjesës së katërt të kolanës “Skënderbegasit ndër vite...”, i autorëve Kujtim Boriçi e Maksi Fejzulla. Aktiviteti u zhvillua me mbështetjen e Ambasadores Luella Hajdaraga, me angazhimin e Shoqatës Kombëtare të Ushtrakeve në Rezervë të Shqipërisë, degës së saj në Athinë dhe shtëpisë botuese “Enja”. Në këtë aktivitet, merrnin pjesë ushtarakë në lirim në Greqi, shkrimtarë, poetë publicistë shqiptar me banim në shtetin fqinj dhe vendas, kolegë të autorëve etj...Të pranishëm gjithashtu ishin Kolonel Roland Berzani, Atasheu ushtarak i Shqipërisë në Greqi; znj. Eliverta Radomi, Ministre këshilltare, përgjegjëse për kulturën në ambasadën shqiptare në Athinë; Thoma Konduri Presidenti i SHKURSH, Shqipëri; Joneda Dodaj, Oficere Koordinuese për Diasporën në Ambasadën Shqiptare në Athinë, Aqif Bozhiqi Kryetari Degës së SHKURSH, dega Greqi. Pas hapjes së aktivitetit dhe prezantimit të librit, vazhduan diskutimet. Në fund, autori Kujtim Boriçi, falënderoi organizatorët për aktivitetin dhe të pranishmit për pjesëmarrjen. Bisedat dhe diskutimet vazhduan gjatë më pas, në koktejin e shtruar nga mikpritësit.



Aqif Bozhiqi (Kreu i SHKURSH, Greqi)

Të dashur pjesëmarrës, të pranishëm sot në këtë promovim të volumit të katërt të kolanës “Skënderbegasit ndër vite...”, të autorëve Kujtim Boriçi e Maksim Fejzulla. Ata kanë bërë një punë të shkëlqyer patriotike duke hulumtuar në arkivat e shumta të historisë së shkollës tonë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, duke na sjellë në duart tona librin voluminoz, “Skënderbegasit ndër vite...”, në katër volumet e tij, një pasuri në duart tona, por që do ta lëmë trashëgim edhe nipërve e mbesave tona. Ne i falënderojmë nga zemra për punën e bërë dhe i urojmë suksese të mëtejshme! Prandaj ne dhe brezat që do të vijnë, kemi se



me çfarë të krenohemi. Ne kemi historinë tonë, heronjtë tanë. Ne nuk kemi përse të montojmë histori e heronj, siç mundohen të bëjnë disa të tjerë. Ne duhet të krenohemi dhe ta mbrojmë këtë histori që kemi nga balta që është hedhur e hidhet nga humbësit dhe bashkëpunëtorët e fashizmit...



ELIVERTA RADOMI (Ministre Këshilltare, përgjegjëse për kulturën në ambasadën shqiptare në Athinë)

Ndihem shumë krenare që në emër të ambasadores znj. Luella Hajdaraga, dhe si një vajzë, motër dhe mbesë oficeri, sot jam këtu në këtë aktivitet të rëndësishëm. Libri i Boriçit e Fejzullait, është një vlerë dokumentare e historike për shkollën e lavdishme “Skënderbej”, për ushtarakët shqiptarë ndër dekada. Ushtarakët, për vite me radhë kanë mbartur dhe përçuar idealin dhe vlerat tradicionale të ushtrisë shqiptare që ka si bosht qendror, besimin ndaj Kombit, Atdheut dhe detyrës. Duke u qëndruar besnikë këtyre vlerave, kanë ndihmuar Kombin dhe popullin tonë të qëndrojnë në këmbë përballë vështirësive. Këto vlera, nuk kanë ngjyrim politik, nuk janë të majta, të djathta, qendrore, konservatore apo liberale. Do të jenë vlerat e vendit, të kombit, të popullit shqiptar. Ju u keni mësuar brezave për vlerat që ka një ushtar: 1. Dinjiteti - Si i trajtojmë të tjerët; 2. Integriteti - Si sillemi; 3. Shërbimi përpara Vetes - Gjetja e nderit është duke i vendosur interesat e kombit përpara interesave personale; 4. Llogaridhënia - Veprimi moral dhe etik, duke iu përmbajtur kodeve të sjelljes, rregulloreve, politikave dhe udhëzimeve.

Këto katër vlera thelbësore formojnë themelin e filozofisë së një ushtaraku. Si të tilla, këto vlera kanë përcaktuar karakterin tuaj, raportin që keni krijuar ju edhe këtu me njeri tjetrin, për qasjen si ndaj profesionit tuaj ashtu dhe për të gjitha marrëdhëniet ndërpersonale.

Të nderuar autorë, ju të pranishëm e sidomos ata që kanë ardhur nga Tirana. ...Ndërsa qëndrojmë këtu në këtë të diell të bukur, megjithëse të nxehtë, dhe gjithçka që më kalon në mendje është se sa kohë ju desh juve për të arritur këtu. Pavarësisht se kur apo ku jeni dhe jetoni, ju mbeten ushtarakë dinjitozë të mrekullueshëm. Faleminderit për gjithçka që keni bërë për vendin tonë. Ju e bëni krenare ushtrinë tonë, vendin tonë, pavarësisht nga kushtet që jetoni aktualisht. Është e mrekullueshme që ju kemi pjesë e këtij eventi. Faleminderit dhe suksese autorëve.

THOMA KONDURI (President i SHKURSH, Shqipëri)

Falënderoj veçanërisht Ambasadoren e RSH në Greqi, Znj. Luella Hajdaraga, e cila e ka kthyer Ambasadën në një vatrë, ku bashkatdhetarët tanë mblidhen, jo rrallë, për të përkujtuar dhe festuar datat e historisë tonë kombëtare apo edhe veprimtaritë të tjera kulturore. Do të falënderoja gjithashtu edhe kolegun tonë, Atasheun Ushtarak, kolonel Roland Berzani, i cili gjithashtu mban lidhje produktive me mbështetjen dhe përkrahjen që i jep të dy shoqatave tona të ushtarakëve në Athinë, për të realizuar misionin e tyre edhe këtu në emigracion. Sot na ka mbledhur promovimi i Vol. 4-të të kolanës “Skënderbegasit ndër vite...”, i kolegëve tanë Kujtim Boriçi dhe Maksim Fejzulla. Për mua kolana “Skënderbegasit ndër vite...” është një vepër jo thjeshtë shumë voluminoze, por edhe komplekse. Ajo është enciklopedi, është informacion, është statistikë, është histori, është biografia e një shkolle legjendë e gjallë e jetuar, jo me disa personazhe me vlera apo heronj, por me mijëra të tillë që kanë bërë emër, kanë lënë gjurmë, kanë bërë histori. Ajo shkollë lindi vetëm 4 muaj pas çlirimit të vendit nga nazi-fashizmi. Ajo ishte shkolla e parë e mesme e profilizuar e pasçlirimit. Ajo u mbush nga pionierë partizan të UNÇ, të sapo zbritur nga malet. ... Ishte ajo shkollë që brumosi 47 breza me dashurinë për vendin, për popullin e tij, për edukatorin dhe shokun. Ajo shkollë ishte vazhdimisht në pararojë të arsimit shqiptar. Libri që po promovojmë sot është vazhdim i përjetësismit



të historisë e të lavdisë të asaj shkolle, si nëpërmjet zbulimit të materialeve arkivore, të mbyllura në dosjet e tyre, ashtu edhe nëpërmjet përshkrimeve të fakteve, ngjarjeve, proceseve të jetuara nga vetë skënderbegasit dhe personeli komandues e pedagogjik, si bashkautor të kësaj ndërmarrje të madhe të skënderbegasve, Kujtim Boriçi dhe Maksim Fejzulla. Libri ka 16 kapituj ku secili ka veçorinë e tematikës por edhe të mënyrës të trajtimit të fakteve. Libri ka rrjedhshmëri historike që fillon me hapjen e shkollës, por pa përsëritur në asnjë fakt trajtimet në volumet e mëparshme. Në libër gjejmë gjerësinë e kontributit të skënderbegasve në ushtri dhe sektorë të tjerë të vendit si në shkencë, art, sport, mjekësi, biznes, etj. Në një kapitull më vete është evidentuar kontributi i disa skënderbegasve edhe në luftën e UÇK-së. Kapitull të veçantë zë edhe organizimi i sotëm i skënderbegasve në vendet ku kanë emigruar. Personazhe dhe bashkautorë janë edhe mbi 25 anëtarë të degës tuaj të Athinës, të cilët janë vetëafruar kësaj nisme. Dua ta mbyll fjalën time me vlerësimin, për domosdoshmërinë e kësaj kolane për shoqërinë ushtarake të vendit tonë. Kjo kolane do të mbetet një pasuri e jona intelektuale, e cila do të na ngacmojë në kujtesën tonë me mësimin se po nuk ditëm se kush ishim dhe nga vijmë, nuk do të gjejmë veten se ku jemi dhe nuk do të dimë se ku shkojmë.

KOLONEL ROLAND BERZANI (Atasheu ushtarak i Shqipërisë në Greqi)

...E pritëm me angazhim e përgjegjësi projektin për promovimin në Athinë të volumit të katërt të librit “Skënderbegasit ndër vite...”, të miqve të mi, Kujtim Boriçi dhe Maksi Fejzulla. Falënderoj me këtë rast dhe mbështetjen e ambasadores Hajdaraga dhe kolegëve të tjerë në ambasadë. Falënderoj dhe z. Aqif Bozhiqi, kreun e Degës së Shoqatës së Ushtrakeve të Liruar të Shqipërisë, për Greqinë, i cili bëri gjithçka për këtë aktivitet. Po ashtu, falënderoj të gjithë pjesëmarrësit, ushtarakë në rezervë që janë këtu, por dhe të tjerët që për arsye objektive nuk mundën të vinin, pasi si njerëz të integruar me dinjitet në Greqi, mbajnë lart nderin dhe dinjitetin e ushtarakut dhe vendit tonë. Për vlerat e librit, unë nuk dua të ndalem shumë, pasi folën e do të flasim dhe të tjerë këtu, por dua të theksoj se kjo kolane, do të mbetet jo thjeshtë një numër librash, por dokumente me vlerë për ushtarakët, studiuesit dhe lexuesin, sot e në dekadat që do vijin. Se Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, ka shkruar një histori dinjiteti në arsimin shqiptar.

Falënderim i autorit, Kujtim Boriçi

I emocionuar dhe mirënjohës, e ndjej për detyrë, që dhe në emër të bashkautorit Maksi Fejzulla, të falënderoj nga zemra të gjithë organizatorët dhe kontribuuesit që mundësuan këtë aktivitet të veçantë në mjediset e Ambasadës së Shqipërisë në Athinë të Greqisë, promovimin e volumit të katërt të kolanës “Skënderbegasit ndër vite...”; Ambasadores e Shqipërisë në Greqi, znj. Luella Hajdaraga; Kolonel Roland Berzani, Atasheu Ushtarak të Shqipërisë në Greqi; znj. Eliverta Radomi, Ministre këshilltare, përgjegjëse për kulturën në ambasadën shqiptare në Athinë; Thoma Konduri, presidenti i SHKURSH, Shqipëri; Aqif Bozhiqi, kryetari Degës së SHKURSH, dega Greqi; gjithë pjesëmarrësit, diskutantët, kolegë gazetarë me banim e aktivitet në Greqi e të ardhur nga Shqipëria; kolegë të medias që e përcollën gjerësisht këtë aktivitet mbresëlënës, në të dy vendet. Faleminderit! **Kujtim Boriçi**

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S TAKIM ME ANËTARËT E PARLAMENTIT TË BE-SË

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg mori pjesë në një takim të përbashkët të Komitetit të Punëve të Jashtme të Parlamentit Europian dhe të Nënkomitetit për Sigurinë dhe Mbrojtjen për diskutime mbi vendimet e Samitit të NATO-s dhe mbi bashkëpunimin midis NATO-s dhe Bashkimit Europian. Duke folur me anëtarët e parlamentit të BE-së, Sekretari i Përgjithshëm e përshkroi Samitin e NATO-s në Madrid si “historik dhe transformues”. Ai tha se Ukraina mund të llogarisë mbështetjen e NATO-s, “për aq kohë sa duhet”, sepse një Ukrainë e fortë dhe e pavarur është jetike për sigurinë e zonës euroatlantike dhe për stabilitetin global.

Z. Stoltenberg tha se në Samit aleatët vendosën “rishikimin më të madh në parandalimin dhe mbrojtjen tonë që nga Lufta e Ftohtë” për t’iu përshtatur një realiteti të ri të sigurisë. Aleanca do të forcojë mbrojtjen përpara, do të forcojë grupet e betejës në pjesën lindore të Aleancës, do të rrisë numrin e forcave të gatishmërisë së lartë në mbi 300 000 dhe do të para-pozicionojë pajisjet dhe rezervat e furnizimeve ushtarake.

Duke folur për aplikimin e Finlandës dhe Suedisë për anëtarësim në NATO, ai tha se është mirë për Finlandën, për Suedinë, për NATO-n, për stabilitetin në të gjithë zonën euroatlantike dhe gjithashtu tregon se dera e NATO-s është e hapur. Sekretari i Përgjithshëm theksoi se në Madrid liderët e NATO-s miratuan një Koncept të ri Strategjik. Ai tha se Koncepti Strategjik i NATO-s dhe Busulla Strategjike e BE-së janë dokumente të ndryshme, por ato “pasqyrojnë të njëjtin realitet” në një botë më të rrezikshme, konkurruese dhe të paparashikueshme.

BE dhe NATO, bashkëpunim në nivel të lartë

Në fjalën e tij në takimin e përbashkët të Komitetit të Punëve të Jashtme të Parlamentit Europian dhe Nënkomitetit për Sigurinë dhe Mbrojtjen, ku u pasua nga një shkëmbim pikëpamjesh me anëtarët e Parlamentit Europian, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, shprehu kënaqësinë e tij për këtë takim për shkëmbim pikëpamjesh të rëndësishme. “Është gjithmonë kënaqësi për mua si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s të takoj parlamentarët e NATO-s dhe për mua këto angazhime janë një mënyrë për t’u siguruar që ne jemi vazhdimisht duke zhvilluar dhe forcuar bashkëpunimin ndërmjet BE-së dhe NATO-s, menjëherë pas Samitit të NATO-s, -tha ai, -ne patëm një Samit në Madrid vetëm disa ditë më parë. Në atë samit ne ripërsëritëm mbështetjen e fortë në NATO për bashkëpunimin ndërmjet BE-së dhe NATO-s. Në takim morën pjesë si presidentja von der Leyen ashtu edhe presidenti Charles Michel. Ne të gjithë e kuptojmë se BE-ja dhe NATO-ja, jemi dy organizata të ndryshme, por ne ndajmë shumë nga të njëjtat sfida, ne ndajmë të njëjtën fqinjësi dhe punojmë gjithnjë e më shumë së bashku. Ne shohim gjithashtu se në dritën e luftës, krizës, në Ukrainë, sanksioneve ekonomike të vendosura nga BE, e gjithë mbështetja për Ukrainën e dhënë nga Bashkimi Europian, funksionon shumë mirë krah për krah me përpjekjet e aleatëve të NATO-s gjithashtu për të vendosur sanksione, por edhe të sigurojë mbështetje të konsid-



erueshme ushtarake dhe ekonomike për Ukrainën. Kjo vërtet tregon unitetin e BE-së dhe NATO-s”, - tha ai dhe kujtoi dy deklaratat e mëparshme të nëshkruara midis NATO-s dhe BE-së gjatë bashkëpunimit, por dhe për nevojën e një deklarate të tretë. “Kam pasur privilegjin të nënshkruaj një deklaratë të përbashkët për bashkëpunimin NATO-BE (dy herë në fakt), me Presidentin Donald Tusk dhe Presidentin Jean-Claude Juncker dhe tani me von der Leyen, Michel dhe unë kemi rënë dakord që ne duhet të shqyrtojmë deklaratën e tretë. Nuk jam në gjendje t’ju them saktësisht se kur do të mund të kemi një deklaratë të tretë, por kjo është diçka që tani mbështetet nga dy presidentët e BE-së dhe unë, kështu që do të fillojmë të punojmë për këtë sa më shpejt të jetë e mundur. Mendoj se është e dobishme të kemi një deklaratë për të përshkruar prioritetet kryesore dhe gjithashtu për të siguruar që 74 projektet që kemi identifikuar tashmë, se po i ndjekim dhe i zbatojmë ato”, -tha ai

BE dhe NATO ndajnë të njëjtat sfida

Duke folur shkurtimisht për Samitin e Madridit, z. Stoltenberg tha se ai ishte një samit historik dhe transformues, ai theksoi vetëm katër nga vendimet kryesore që janë të rëndësishme edhe për Europën dhe BE-në.

Së pari, rritja e mbështetjes për Ukrainën: “Siç e dini, Aleatët e NATO-s ofrojnë nivele të paprecedentë të mbështetjes ushtarake për Ukrainën. Në fakt, Aleatët e NATO-s dhe NATO-ja kanë qenë atje që nga viti 2014, duke të trajnuar, pajisur dhe mbështetur Forcat e Armatosura të Ukrainës. Por sigurisht që nga pushtimi në shkurt, aleatët janë rritur ndjeshëm dhe ne gjithashtu ramë dakord për një paketë gjithëpërfshirëse ndihme gjithashtu se si ta ndihmojmë Ukrainën të kalojë nga pajisjet e epokës sovjetike në pajisje më moderne të standardeve të NATO-s, dhe gjithashtu si të ofrojmë më shumë mbështetje afatgjatë, në ndërtimin e institucioneve të mbrojtjes dhe sigurisë në Ukrainë. Mesazhi ishte se ne do të ofrojmë mbështetje për aq kohë sa të duhet. Askush nuk mund të parashikojë saktësisht se kur do të përfundojë kjo luftë. Por ajo që dimë

është se sa më shumë të jemi në gjendje t’i ofrojmë mbështetje Ukrainës, natyrisht aq më shumë do të rrisim mundësinë, gjasat, për t’i dhënë fund kësaj lufte që ndodh me kushte të pranueshme për Ukrainën, dhe kjo është përgjegjësia jonë”, -tha Stoltenberg për t’i ndihmuar ata të ruajnë të drejtën për vetëmbrojtje dhe kjo është pikërisht ajo që bëjnë Aleatët e NATO-s. Ky ishte gjithashtu mesazhi i qartë nga Madridi, duke deklaruar në të njëjtën kohë se NATO nuk është pjesë e luftës, “ne mbështesim Ukrainën, një partner shumë i vlerësuar, por NATO nuk do të përfshihej drejtpërdrejt në luftimet në terren në Ukrainë”, -tha Stoltenberg.

Së dyti, ndryshim më të madh themelor në parandalimin dhe mbrojtjen: “Ne ramë dakord për një ndryshim më të madh të përgjithshëm themelor në parandalimin dhe mbrojtjen tonë që nga Lufta e Ftohtë në të gjitha fushat, ajër, det, tokë, hapësirë kibernetike, sepse ne jetojmë në një botë më të rrezikshme, dhe për këtë arsye NATO duhet të bëjë më shumë për detyrën tonë thelbësore: mbrojtjen e të gjithë aleatëve. Kur bëhet fjalë për fushën tokësore, e cila ka qenë ndoshta zona ku ka pasur më shumë fokus, ajo që ne bëjmë bazohet në tre elementë kryesorë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. “Njëra është mbrojtja më përpara, që do të thotë më shumë trupa, veçanërisht në pjesën lindore të Aleancës. Tashmë kemi rritur praninë tonë pas pushtimit rus të Ukrainës. Ne kemi dyfishuar numrin e grupeve luftarake nga katër në tetë. Pra, tani ne kemi grupe betejë jo vetëm në vendet baltike dhe Poloni, por ato në Rumani, Sllovakia, Hungari dhe Bullgari. Dhe ne në fakt kemi dyfishuar madhësinë e grupeve të betejës me më shumë trupa në secilin prej grupeve të betejës. Më pas, ne kemi rënë dakord të rrisim më tej, më shumë trupa për të kryer mbrojtjen përpara, praninë përpara, dhe gjithashtu deklaruar se mund ta shkallëzojmë këtë në madhësinë e nivelit të brigadës, që është dukshëm më shumë se batalionet që formuan grupet e betejës origjinale në pjesën lindore të Aleancës”, - theksoi Jens Stoltenberg. Ai tha se kjo është ndërtimi i asaj që NATO ka bërë tashmë. “Siç e dini, tani ne kemi 42 000 trupa kryesisht në pjesën lindore të Aleancës, nën komandën e drejtpërdrejtë të NATO-s si një përgjigje e drejtpërdrejtë

ndaj pushtimit rus të Ukrainës”.

Më pas, kjo do të mbështetet nga më shumë forca të gatishmërisë së lartë. Dhe në planet e reja të mbrojtjes dhe në punën që po vazhdon tani dhe të rënë dakord nga krerët e shteteve dhe qeverive, kjo është diçka që duhet ta zbatojmë në vitin e ardhshëm. Plani është që të ketë rreth, ose në fakt mbi, 300 000 trupa në gatishmëri të lartë në të gjithë Aleancën. Shumica e tyre do të jenë në vendet e tyre të origjinës, por shumë prej tyre do të kenë territore të paracaktuara që duhet të mbrojnë. Ata do të stërviten, do të ushtrohen atje rregullisht. Gjermania tashmë ka njoftuar se do të ketë një brigadë në Gjermani, por që do të jetë me rrotacion brenda dhe jashtë Lituanisë. Kështu ata do të njohin terrenin dhe do të dinë të punojnë me forcat e mbrojtjes vendase dhe të jenë të përgatitur për t’u vendosur atje në kohë krize. Pra, këto nuk janë të dislokuara në mënyrë të përhershme, por janë forca të paracaktuara, me gatishmëri të lartë, që mund të dislokohen në pjesë të ndryshme të Aleancës, veçanërisht në pjesën lindore të Aleancës, me një njoftim të shkurtër. Elementi i dytë janë forcat e gatishmërisë së lartë dhe elementi i tretë janë pajisjet shumë më të paravendosura. Në fakt është mjaft e lehtë të lëvizësh njerëz, personel. Ajo që kërkon kohë është lëvizja e pajisjeve të rënda, municionit, karburantit. Pra, ideja është që të kemi pjesërisht më shumë forca në vend, pjesërisht më shumë forca gatishmërie të larta, ushtrime të rregullta dhe më pas pajisje të parapozicionuara në vend. Dhe duke e pasur atë, ne mund ta përforcojmë shpejt nëse është e nevojshme. Këta janë elementët kryesorë të konceptit të mbrojtjes të rënë dakord në Samitin e Madridit”.

Vendimi i tretë, Finlanda dhe Suedia: “Vendimi i tretë, që do të përmend për ju është sigurisht vendimi për të ftuar Finlandën dhe Suedinë për t’u bashkuar. Ky është një vendim historik dhe ishte e rëndësishme që të tridhjetë aleatët ranë dakord të ftonin Finlandën dhe Suedinë”, - nënvizoi Stoltenberg. Dhe tani ajo se çfarë mbetet është se ne kemi nënshkruar Protokollet e Anëtarësimit dhe tani na duhet ratifikimi në tridhjetë parlamente dhe sapo të ndodhë kjo Finlanda dhe Suedia do të jenë anëtarë të NATO-s. Kjo është e mirë për Finlandën dhe

Suedinë, është e mirë për NATO-n dhe është e mirë për stabilitetin në të gjithë zonën euro-atlantike. Gjithashtu tregon se dera e NATO-s është e hapur. Duhet të mbani mend se deri në fund të dhjetorit, Presidenti Putin i propozoi NATO-s një të ashtuquajtur “traktat sigurie” që ne duhet ta nënshkruanim, duke thënë shumë gjëra, por ndër gjërat që ai donte që ne të nënshkruanim ishte para së gjithash garantimi që nuk do të “nënshkruanim” anëtarë të rinj në NATO. Së dyti, ishte që ne duhet të heqim të gjitha trupat dhe infrastrukturën nga anëtarët e NATO-s që u bashkuan pas vitit 1997, që do të thotë se të gjithë anëtarët në pjesën lindore të Aleancës nuk duhet të kenë trupa të NATO-s, asnjë infrastrukturë të NATO-s, duke futur anëtarësimin e tyre në NATO të klasit të dytë”, -tha ai. “Sigurisht, ne nuk e pranuam këtë. Ai pushtoi Ukrainën sepse donte më pak NATO në kufijtë e tij. Ajo që po merr presidenti Putin është më shumë NATO, ai po merr pikërisht të kundërtën. Më shumë prani ushtarake e NATO-s në pjesën lindore të Aleancës dhe dy anëtarë të rinj të NATO-s dhe Dera e NATO-s mbetet e hapur, demonstruar nga Finlanda dhe Suedia”.

Vendimi i katërt, Koncepti i ri Strategjik: “Mund ta lexoni, është një dokument i bukur. Edhe ju keni Busullën tuaj Strategjike, dhe sigurisht që ato janë përsëri, dokumente të ndryshme, por ato pasqyrojnë të njëjtin realitet dhe kjo është një gjë e mirë, duke reflektuar sigurisht që ne kemi të përbashkët shumë anëtarë të njëjtë. E rëndësishme me Konceptin Strategjik është që ne, si Aleancë, biem dakord për drejtimin strategjik të kësaj Aleance në një botë më të rrezikshme, më konkurruese dhe më të paparashikueshme. Isha i pranishëm në Lisbonë kur ramë dakord për Konceptin e mëparshëm që skadoi në të vërtetë në Samitin e Madridit disa ditë më parë. Në atë samit, në atë kohë presidenti Medvedev ishte i pranishëm nga Rusia, mori pjesë në takimin e NATO-s dhe në Koncept u pajtuam që Rusia ishte partner strategjik. Ky nuk është rasti në Konceptin aktual Strategjik. Atje ne në fakt adresojmë qartë se Rusia përbën kërcënimin më të drejtpërdrejtë për sigurinë tonë”. Në Konceptin e mëparshëm Strategjik Kina nuk përmendej me asnjë fjalë të vetme. “Tani ne adresojmë sfidat që Kina paraqet për interesat tona, për vlerat tona, për sigurinë tonë dhe gjithashtu që Kina dhe Rusia po punojnë gjithnjë e më ngushtë së bashku. Ne trajtojmë kibernetikën, ndryshimet klimatike, teknologjinë dhe shumë çështje të tjera.

Është gjithashtu e rëndësishme të them se Koncepti Strategjik, gjithashtu, mban një qëndrim shumë të qartë për rëndësinë e vlerave demokratike, të të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës, të cilat janë vlera thelbësore për NATO-n dhe unë i kushtoj shumë rëndësi atyre vetë”. NATO dhe BE janë dy organizata që punojnë ngushtësisht së bashku dhe “është mirë të shohësh se dy organizata të ndryshme, NATO dhe BE, kanë gjithnjë e më shumë të përbashkëta dhe punojnë gjithnjë e më shumë së bashku. Kjo është mirë për BE-në, është mirë për NATO-n dhe është mirë për të gjithë ne”, - tha Stoltenberg.

NATO riafirmon angazhimin për sigurinë bashkëpunuese

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm hap Simpoziumin vjetor të Partneriteteve 360 të NATO-s

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoană hapi Simpoziumin vjetor të Partneriteteve 360 të NATO-s, një forum që mbledh së bashku përfaqësues civilë dhe ushtarakë nga vendet aleate dhe partnere për të lehtësuar dialogun mbi të ardhmen e politikës së partneriteteve të NATO-s. Në fjalën e tij të hapjes, z. Geoană theksoi vlerën e partneritetit të NATO-s, si për aleatët, ashtu edhe për vendet dhe organizatat me të cilat NATO bashkëpunon.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm kujtoi se në Samitin e fundit në Madrid, krerët e shteteve dhe qeverive aleate përsëritën rëndësinë e partneriteteve të NATO-s dhe riafirmuan angazhimin e Aleancës për sigurinë bashkëpunuese, veçanërisht në një mjedis sigurie gjithnjë e më sfidues. Udhëheqësit morën gjithashtu vendime kyçe për partneritetet e NATO-s. Kjo përfshinte ftesën e partnerëve të ngushtë Finlandën dhe Suedinë për t'u bashkuar me NATO-n, rritjen e mbështetjes për Ukrainën dhe miratimin e mbështetjes për partnerët përfshirë Bosnjën dhe Hercegovinën, Gjeorgjinë, Moldavinë, Mauritaninë dhe Tunizinë. Aleatët ranë dakord më tej të forcojnë angazhimin e NATO-s me Bashkimin Europian, si dhe me partnerë të tjerë përtej zonës euro-atlantike që ndajnë vlerat dhe interesat e Aleancës.

Simpoziumi i Partneriteteve të NATO-s 360 ofron një mundësi për përfaqësuesit nga anëtarët e NATO-s dhe vendet partnere që të reflektojnë mbi evoluimin e partneriteteve të NATO-s, të ndajnë perspektivat dhe të kërkojnë fusha të reja konkrete për rritjen e bashkëpunimit. Edicioni i Simpoziumit i vitit 2022 në Gjenevë, Zvicër, duke shënuar herën e parë që një vend partner i NATO-s priti Simpoziumin.



STABILITETI STRATEGJIK

Nënsekretarja e SHBA-së për Kontrollin e Armëve dhe Sigurinë Ndërkombëtare viziton selinë e NATO-s

Aleatët e NATO-s ndanë pikëpamjet mbi kontrollin e armëve dhe stabilitetin strategjik me nënsekretaren e SHBA-së për Kontrollin e Armëve dhe Sigurinë Ndërkombëtare.

Ambasadorja Bonnie Denise Jenkins (nënsekretarja e SHBA për Kontrollin e Armëve dhe Sigurinë Ndërkombëtare) vizitoi selinë e NATO-s, ku u takua me Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, z. Mircea Geoană, dhe aleatët e NATO-s në kuadër të Komitetit Special Këshillues dhe Konsultativ të Kontrollit të Armëve, Çarmatimit dhe Mospërhapjes (ADNC).

Diskutimet u fokusuan në tre tema kryesore: 1. Kontrolli i Armëve në kontekstin e luftës së agresionit të Rusisë dhe të Konceptit të ri Strategjik të NATO-s, i cili u miratua në Samitin e Madridit; 2. Përgatitjet e vazhdueshme për Konferencën e Dhjetë të Rishikimit të Traktatit për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore (NPT) që do të mbahet në gusht 2022; dhe 3. Përpjekjet dhe prioritetet e SHBA-së në kontrollin e armëve dhe sigurinë ndërkombëtare.

Në Samitin e Madridit, udhëheqësit e aleatëve ripohuan se stabiliteti strategjik, i ofruar përmes parandalimit dhe mbrojtjes efektive, kontrollit të armëve dhe çarmatimit, dhe dialogut politik kuptimplotë dhe reciprok, mbetet thelbësor për sigurinë tonë të përbashkët. Rezultatet e mëtejshme të Samitit përforcuan rëndësinë e kontrollit të armëve, çarmatimit



dhe mospërhapjes për reduktimin e rrezikut dhe rritjen e sigurisë, transparencës, verifikimit dhe pajtueshmërisë. Aleatët riafirmuan gjithashtu angazhimin e tyre për të vazhduar ndjekjen e të gjithë elementëve të reduktimit të rrezikut strategjik, duke përfshirë mjetet që promovojnë ndërtimin e besimit dhe parashikueshmërinë përmes dialogut, rrisin mirëkuptimin dhe vendosin menaxhimin dhe parandalimin efektiv të krizës. NATO mbetet një platformë e rëndësishme për diskutime të thella dhe konsultime të ngushta mbi këto dhe përpjekjet e lidhura me to.



Gjenerallejtnant Nielsen u zgjodh komandant i ri i Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s

Merr detyrën nga gjenerallejtnant Olivier Rittmann në verën e vitit 2023

Komiteti Ushtarak i NATO-s zgjodhi gjenerallejtnant Max A.L.T. Nielsen të jetë komandanti i ri i Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s. Gjenerallejtnant Nielsen ka shërbyer si Përfaqësues Ushtarak në NATO dhe BE që nga viti 2019. Ai do të marrë detyrën nga gjeneral-lejtnant Olivier Rittmann në verën e vitit 2023. Kolegji i Mbrojtjes i NATO-s (NDC) ka trajnuar udhëheqës ushtarakë dhe civilë për më shumë se 70 vjet. Misioni i tij është të kontribuojë në efektivitetin dhe kohezionin e Aleancës, kryesisht përmes arsimit të nivelit të lartë, mbi çështjet e sigurisë transatlantike, të mundësuar nga kërkimet mbi çështjet që lidhen me Aleancën dhe të mbështetur nga angazhimi me aleatët, partnerët dhe entitetet jo-NATO (NNE), me një qasje 360 gradë për çështjet e sigurisë.

Komandanti siguron që NDC-ja të përmbushë misionin e saj për të kontribuar në efektivitetin dhe kohezionin e Aleancës duke zhvilluar rolin e saj si një qendër kryesore e edukimit, studimit dhe kërkimit mbi çështjet transatlantike. Komandanti është përgjegjës para Komitetit Ushtarak, por përgjegjësitë dhe kompetencat e tij e autorizojnë atë të komunikojë me agjencitë e NATO-s, autoritetet kombëtare të anëtarëve të NATO-s, institucionet akademike, si Konsorciumi i PTP-së dhe individët sipas rastit. Ai gjithashtu mund të ndërlihet me organet kombëtare jo anëtare të NATO-s për qëllime të programeve të miratuara nga Këshilli i Atlantikut të Veriut, siç është Dialogu Mesdhetar. Bordi Këshillimor Akademik, i kryesuar nga Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer, këshillon komandantin e Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s mbi mënyrat për të përmirësuar më tej aktivitetet, lidhjet dhe shtrirjen e programeve të tij.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Toka jonë është një planet unik në univers, shtëpia jonë e vetme. Çdo person duhet të kujdeset për mjedisin dhe të mos shpresojë për një tjetër.

Ekologjia e tokës çdo ditë vuan më shumë dhe më fortë, bimët e reja janë ndërtuar, gjithnjë e më shumë makina shfaqen në rrugë, raketa dhe satelitë janë nisur në hapësirë. Kjo çon në ndotjen e ajrit, ngrohjen globale dhe duke shkruar akullnajat shfaqen vrimat e ozonit. Të gjitha llojet e kafshëve për shkak të prerjes së pyjeve, shumë gjitarë ujorë dhe peshqit janë kërcënuar prej kohësh me zhdukje për shkak të kontaminimit të ujërave.

Në qytetet e mëdha, njerëzit vuajnë nga sëmundje të traktit të frymëmarrjes dhe kjo për shkak të ekologjisë së bastarduar nga dora njerëzore.

Pas qytetit grumbujt e mbeturinave rriten, sepse paketat dhe shishet nuk përpunohen. Këto “gjëra të vogla”, për të cilat nuk mendojmë, çojnë në riprodhimin e brejtësve dhe shfaqjen e sëmundjeve të reja.

Për të mbrojtur tokën tonë nga vdekja, të gjithë duhet të fillojnë me veten, para së gjithash duhet të jetë qëndrim i kujdesshëm për natyrën, bimët që na japin ajër duhen trajtuar me “dashurinë e një fëmije” që jeta të marrë frymë.

Nëse të gjithë shikojnë veten dhe kujtojnë se sa dëm i kanë shkaktuar natyrës, dhe pas kësaj do të përpiqen të jenë më të mençur dhe të kujdesshëm, atëherë “planeti blu” do të ekzistojë pa deformime.

Jeta njerëzore është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me natyrën, me tokën. Toka është “shtylla kurizore” pa të cilën nuk do mund të qëndronte njerëzimi në formatin e sotëm. Një person jeton dhe shqetësohet mbi të, ndan me të gëzimin dhe pikëllimin e saj.

Për shumë prej nesh, koncepti i tokës është i lidhur me shtëpinë, me të afërmit, me një lumë, ku kaloi fëmijërinë, duart, lodrat, përralla, rrugë, bar, pyje, retë në qiell dhe shumë-shumë më tepër, është ideja jonë e parë e tokës amtare, për një botë të madhe komplekse.

Ne jemi pronarët e tokës, pronarët e të gjithë të gjallëve që dekorojnë jetën tonë. Por nëse jemi pronarë, atëherë duhet të jemi dhe mbrojtësit e saj, sepse është e pamundur vetëm të posedojmë, duke mos paguar për ekzistencën unike të saj.

Për disa arsye, bëhet shumë e dhimbshme, sa njerëz e braktisën vendin, duke i dhënë konfuzion të gjithë “dëmtuesve” të mundshëm, termocentraleve bërthamore, bimë pa shpirt...

Ju shikoni fushat e braktitura, kasollet e shkatërruara në fshatra, tharjen e lumenjve dhe madje edhe detet e tërë. Peshqit dhe kafshët vdesin kudo, zhduken nga fytyra e tokës së bimës, ajri i pastër zhduket diku. Dhe shirat e acidit janë derdhur në tokë, dhe shfaqen vrima të reja të ozonit dhe për disa arsye rriten luleshtrydhe ose patate gjigande.

Planeti ynë sikur nxori një maskë të tmerrshme

Sa dhimbje i japin njerëzit e saj pa shpirt, duke krijuar punët e panjohura!

Toka të ushqen me bukë, ujë të pastër, të befason me bukurinë e saj, por a mjafton kjo për tu ndier zotë të saj?

Sot, një nga problemet e rëndë-

Nëse të gjithë shikojnë veten dhe kujtojnë se sa dëm i kanë shkaktuar natyrës, dhe pas kësaj do të përpiqen të jenë më të mençur dhe të kujdesshëm, atëherë “planeti blu” do të ekzistojë pa deformime.

Njerëz, planeti në duart tona!



sishme është kërcënimi i një katastrofe ekologjike.

Ne përjashtojmë indiferencën, ne justifikojmë punësimin, miopinë dhe shumë arsye të tjera që janë të kuptueshme vetëm për ne, dhe në asnjë mënyrë për natyrën tonë. Ne po fillojmë të jemi të zemëruar, kur çdo vit bëhet gjithnjë e më pak hapësirë për rekreacion, sepse lumenjtë, liqenet dhe deti janë të ndotura. Pastaj fillon të vlijë ndërgjegjen e zgjuar publike dhe ne jemi të indinjuar kur vendet për peshkim zhduken.

Por, në fund të fundit, ne të gjithë më shumë harrojmë të heqim zjarrin në pyll, përmes të cilit më së shumti mbjelljet e gjelbra zhduken, ne derdhim një numër në rritje të deodorantëve që gjatë viteve reduktojmë shtresën e ozonit.

Njerëz, zgjohuni, shikoni prapa,

planeti ynë po vdes!

Unë bërtas për të, sepse ai dëshiron të jetojë për t'ju dhënë dashurinë e tij, ngrohtësinë e tij, ujin e tij, oksigjenin e tij... dëgjoni, përgjigjuni për praninë e tij të dëshpëruar.

Bëni diçka! Jini pronarët e fatit tuaj, pasardhësit e vërtetë të një lloji!

Ndaloni shkatërrimin e të gjitha jetëve, sepse po shkatërroni veten me duart tuaja.

Veprimet tona, veçanërisht varësia jonë nga lëndët djegëse fosile dhe konsumi i lëndëve materiale, po nxisin ndryshimin e klimës, shkatërrimin e ajrit, ujit dhe degradimin e tokës. Ne po prishim ekuilibrat e vetë sistemeve që na duhen për të mbijetuar, e këtë po e bëjmë me shpejtësi dhe ritëm të pashembullt. Zhvillimi i qëndrueshëm njerëzor ka të bëjë me aftësimin e njerëzve për

të jetuar në potencial të plotë dhe në mënyra të drejta mjedisore.

Çfarë bëjmë në shekullin e XXI?! Çfarë ndodhi me ekologjinë e tokës?!

Pyjet u dogjën, lumenjtë u kurrën. Nuk mund ta bëjmë këtë! Nuk mund të prishim ujërat e brendshëm! Nuk mund të ndërtonte mbi bimë në qytete!

Si mund të jetojmë kështu?!

Jetojmë pa kataklizma teknike, duke mos rrezikuar të vdesim në tym.

Me ujë të padëmshëm për trupin...

Lëvizni njerëzit, si të mendojmë për njerëzimin, nga gazrat të mos vdesë.

Secili prej nesh duhet të jetë jo vetëm pronari i tokës, por edhe besimtar i saj...

Humanët nuk duhet të luftojnë me natyrën që ajo mos të kthehet në armik për të.

Qëndrimi ndaj natyrës është një nga treguesit kulturorë. Gjithkush është i detyruar të kujdeset për natyrën dhe mjedisin. Njeriu dhe natyra janë të lidhura me njëri-tjetrin.

Pjesëmarrja inteligjente e një personi në jetën e natyrës është e dobishme si për frymorët dhe natyrën, lumenjtë e pastër dhe pyjet e pasura, kafshët dhe zogjtë, toka pjellore dhe uji i pastër janë të nevojshëm për vazhdimin pa trauma të jetës mbi tokë.

Detyra jonë është të shpëtojmë pasurinë e natyrës për të ardhmen. Konsumi, qëndrimi i pamenduar ndaj natyrës nuk do të na falë pasardhësit e ardhshëm.

Gjithkush duhet të mendojë për faktin se natyra mund të shpëtohet vetëm kur të jemi të vetëdijshëm për të vërtetën e thjeshtë: duke bërë dëm për mjedisin, dëmtojmë veten.

Nëna natyrë është unike dhe ideale, ajo mund të jetë e vështirë dhe madje edhe e dhunshme me ne në rastet kur harrojmë faktin se ne jemi vetëm një pjesë e saj.

E egër, e fortë, ajo mund të shkatërronë të gjithë njerëzimin në një sekondë. Kur e krahasojmë historinë tonë me historinë e Tokës, do të shohim se koha e njerëzimit është e vetmja e dytë për planetin tonë. Ne nuk jemi mbretër, zotët e natyrës. Ne jemi vetëm fëmijët e saj të këqij.

Ne nuk jemi vetëm pjesë e natyrës në një kuptim të tillë global. Ne jemi pjesë e natyrës sonë lokale, të shtëpisë sonë të vogël. Vendi im, qyteti im, shtëpia ime është shtëpia ime. Familja ime është shtëpia ime. Dhe natyra e egër jashtë është edhe shtëpia ime.

Bota jonë është shtëpia jonë dhe ne jemi përgjegjës për të, sepse ne kemi një fuqi për ta shkatërruar atë. Mund të jetë një shtëpi komode, e bukur, ose mund të jetë një shkretëtirë e pajetë.

Unë jam e frikësuar nga mendimi se ne kemi kaq shumë fuqi, është e tmerrshme. Disa raketa të vogla bërthamore mund të shfarosin planetin tonë, ato kanë një mundësi për të shkatërruar shtëpinë tonë, lumin tonë të bukur, muzgun tonë dhe ne vetë.

Unë e dua shtëpinë time, familjen time, lulet e oborrit tim, cicërimat e zogjve agimeve të bardha. Nëse duam të mbrojmë jetën, duhet të jemi qytetar i përgjegjshëm, fëmijë i bukur i natyrës, “njeri”.

Bomba atomike shpërthyes ushtarake goditën qytetet e Hiroshimës dhe Nagasakit në vitin 1945. Lufta e vërtetë ekologjike është e njohur për shitje. Ajo është kryer gjithashtu nga amerikanët në Indokita, ku shumë njerëz u helmuan nga Yadochimikati. Dhe megjithatë plagët janë shtrënguar gradualisht.

Por a do të vazhdojmë me frikën e asaj çka historia na servir, apo do ecim përpara për të bashkëjetuar me bekimin e “të mirave” të tokës së hirtë por me zemër të bardhë?!



Besa, kodi i shqiptarëve

Besa si koncept i ka udhëhequr shqiptarët në jetën e tyre shoqërore për shumë vite. Besa është fjala e dhënë, diçka që nuk ka kthim prapa.

Besa, ose kulti i fjalës së dhënë lidhet në burim me mitin biblik të thënies “Në fillim ishte fjala”.

Para se të ishte shkrimi, kontrata, njeriu, bota ishte vetë fjala. Ky kult madhështor, i cili në popujt euro-perëndimor pak nga pak mori karakterin e një idomene fetare kishtarë, te shqiptarët ruajti gjuhën e burimit.

Tek Kanuni i Lekë Dukagjinit i mbledhur nga Shtjefën Gjeçovi, shohim që besa është e ndarë në gjini dhe forma të ndryshme. Këtu përcaktohet rëndësia e besës si: “Sjellje besimtare me anë të së cilës gjithkush që ka nevojë që të shlyej një borxh, duhet të japë një shenjë besimi, duke thirrur Zotin të dëshmojë për të vërtetën”.

Besa mund të bëhet vetëm përpara autoriteteve të njohura nga komuniteti duke bërë një betim solemn. Tre janë ritualet kryesorë nëpërmjet të cilave shprehet fjala e dhënë: mbi gurin, mbi kryqin dhe Vangjelin, dhe mbi kokën e djemve. Deklarata bëhet sipas një rregulli të paracaktuar. Para së gjithave vendoset dita e mbledhjes së gjyqit të pleqve dhe përpara tyre do të vijë kush kërkon që të japë besën. Më pas vijnë deklaratat e gjykatësve dhe të afërmëve të tyre. E drejta e besës bie mbi ata që të cilët kanë pësuar një fyerje. Nuk i lejohet të betohen atyre që kanë qenë dëshmitarë të krimit.

Besa në letërsinë dhe gojëdhënat shqiptare

Pa dyshim se fenomeni i besës është i pranishëm edhe në letërsinë shqiptare. Atë e gjejmë tek gojëdhënat, tek letërsa popullore, në folklori e romane. Për shembull, tek legjenda e Rozafatit.

Aty ku tregohet se për të respektuar besën heshtet edhe kur është fjala për njeriun e zembrës. Apo tek Doruntina dhe Konstadini, kur për ta mbajtur besën e dhënë nënës, Konstadini ngrihet edhe nga varri.

Në anën tjetër, edhe në shumë romane, siç është “Prilli i thyer” shkrimtarit Ismail Kadare filtet për rëndësinë e besës tek shqiptarët dhe për peshën e respektimit të saj. Sipas rregullave të shoqërisë shqiptare nëse dikush zotohet me fjalën “Ta jap besën” për çfarëdo çështje, atëherë mund t’i besoni përfundimisht. Fenomeni i besës ndër shqiptarët u ka bërë gjithmonë përshlyetje të huajve dhe vizitorëve. Ata kanë qenë të mahnitur nga fuqia e këtij zotimi ndër shqiptarët. Nga respektimi i këtij kodi sikurse ai të ishte ligj i shkruar. Kostandini zbërthen kodet e jetës e të vdekjes dhe i bën ato të parëndësishme, të kota, të pavlera, të pafuqishme. Ai nuk është një Faust, por është një njeri që qëndron mbi palët: mbi Jetën e mbi Vdekjen. Qëndron aty me fuqinë që ka vetëm një Zot: Ai që ka çelësat e Botëve. E këtë fuqi ai nuk e mori nga sakrifica, rituale, tempuj, mësimë ezoterike, yjësi enigmatike, Jo! Asnjëra nga këto nuk ishte rruga e Kostandinit. Rruga e tij kalon nga shtegu i lotëve të nënës së tij dhe nga luginat e djegur e dhimbjes, përndryshe, forma që ka shpirti i kësaj nëne; kalon nga Dheu, që i kujton atij se ai është i tepërt për të. Është i tepërt për atë Dhe, pasi shpirti i tij nuk është as i asaj bote e as i kësaj bote. Ky përrua lotësh, kjo luginë e djegur, ky Dhe fisnik, ky shpirt i trazuar dhe e vetmja pemë me lule e luginës, pema Doruntinë, janë elementët e fuqisë së Kostandinit.

Të tërë këta përbëjnë, “frymë e gjak” të Kostandinit, përbëjnë fuqinë e tij jetike, forcën që theu barrierat, forcë e cila e ka emrin BESË. Në emër të saj ai erdhi e iku në heshtje enigmatike. Kjo është ajo forcë e mbinatyrshme që vesh shqiptarët, historitë e tyre mitike në më shumë se një rast, traditën e tyre të kahershme, me një lloj besimi të njëjtë me atë të atyre. Besa e shqiptarit, e ngritur në këtë nivel është një besë, religion ta quajmë nëse duam, organik i shpërndarë në të gjitha viset, duke i veshur vetëdijes së tyre fuqi vendimmarrjeje e vetëgjyqësie, bazuar në kodet më fillestare të ekzistencës njerëzore, më format më arkaike të organizimit të jetës. Ndoshta, kjo arsye, Besa, dhe kjo mënyrë e përballimit me vdekjen, dashurinë, drejtësinë, gjetur veç si tipar hyjnor i Perëndive mitologjike, e shtyn Henry Noel Brailsford që të shprehet për ta: “Janë mbinjeriu i Niçes, këta shqiptarë të moçëm, diçka mes mbretërve dhe tigrave...”.

Historikisht BESA përfaqëson dy aspekte: ajo është një virtyt i lartë moral dhe një institut i së drejtës zakonore të trashëguar brez pas brezi në tri kthesat e mëdha historike të racës sonë: në periudhën e Ilirisë, të Arbërisë dhe Shqipërisë. Si virtyt i lartë moral me zanafillë nga lashtësia ilire, BESA lindi si nevojë e solidaritetit në bashkësinë fisnore. Ajo lidhjet midis personash, familjesh, gjinish, vëllezërish e fisesh. Mbështetja kryesore e besës ishte në kultin e fjalës së dhënë. Ajo duhej të bëhej me çdo kusht e me çdo çmim, sepse ishte një detyrim i lartë moral, një detyrim nderi. Në periudhat e hershme historike të bashkësisë së fiseve ilire dhe sipas mendësisë së asaj kohe, lidhja e besës konsiderohej si një akt hyjnor i pa thyeshëm. Thuhej se hyjnëti ilire e kishin bekuar besën dhe lidhjen e njerëzve me anën e besës, si një akt që lartëson moralisht qenien njerëzore dhe këtë popull, duke e veçuar nga të tjerët, të pabesët. Pësja e fjalës së dhënë, pësja e besës ishte, siç thuhej, më e rëndë se bota.

Besëlidhjen e parë, deri më sot, mbi bazën e kër-kimeve shkencore të disa historianëve tanë të shquar, është BESËLIDHJA e vitit 6 të erës së re (pas Krishtit) midis fiseve ilire: desidiatëve, breukëve, pirustëve, etj. Meqenëse kishte shtrirje të gjerë dhe përfshinte pjesën qendrore e veriore të Gadishullit Ilirik, atë e udhëhoqën dy prijës me emrin Bato, ai i desidiatëve dhe ai i breukëve si dhe Pini, i të njëjtit fis, i cili është shquar në luftimet kundër romakëve. Ajo pati një shtrirje të gjerë që nga Istria jugore, Delmacia (Dalmacia), Bosnja e deri përtej Sremit e SINGIDINIUMIT apo Beogradit të sotëm, që nga Danubi e deri në lumin Mat në Shqipërinë verilindore të sotme. Sipas historianit romak, Sieton, ajo luftë, “ka



qenë më e tmerrshme nga të gjitha luftërat e jashtme që ka bërë Roma, pas luftës me Kartagjenën”. Lufta plasi për shkak të rekrutimit me forcë të të rinjve ilirë për të luftuar kryengritjen e markomanëve gjermanikë. Ilirët që e shihnin me simpati luftën çlirimtare të gjermanikëve kundër shtypjes dhe shfrytëzimit të egër të Perandorisë Romake, nuk pranuan të shkojnë në luftë kundër tyre. Pasi lidhën besën u hodhën në kryengritje kundër Romës.

Duke nuanatur rrezikun e shembjes nga trimëria e ilirëve, romakët lidhën paqe me gjermanikët dhe me të gjitha forcat iu kthyen Besëlidhjes ilire. Pas tre vjetësh luftime, 15 legjione të ushtrisë së rregullt romake dhe po aq trupa ndihmëse dhe me një forcë prej 100 000 ushtarësh, sulmoi Ilirinë. Batoja i desidiatëve qëndroi deri në fund në kështjellën e Anëdetit (Anëdetrit), Spliti i sotëm. Të fundit ranë desidiatët e Bosnjës dhe pirustët e viseve të sotme të Shqipërisë verilindore. Por, Besa si akt i shenjtë vijoi të ruhet edhe kur shoqëria ilire nga bashkësia e parë fisnore kaloi në shoqërinë me klasa e në formacione shtetërore, në Konfederatën e shteteve fisnore ilire dhe në mbretëritë ilire. Ajo mori funksione të rëndësishme sidomos, në situatat e ngjashme në atë që përshkruam më sipër dhe u bë mjetqëndrese kundër pushtuesve të huaj në luftërat e pandërprera mijërvjeçare.

Të trimëruar nga BESËLIDHJA edhe pse të pushtuar, ilirët nuk nënshtroheshin shpirtërisht. Në sajë të Besës, këtij detyrimi të lartë moral, ne sot kemi njësinë më të rëndësishme, gjuhën shqipe si bijë të ilirishtes, si njësi kombëtare dhe tipar dallues i shqiptarit që përbën thesarin më të madh që kemi trashëguar nga stërgjyshërit tanë ilirë. Kjo BESË e ka mbrojtur jetën shqiptare në çdo hallkë të sajën, për pasojë edhe aspektin gjuhësor, pasi duke mbrojtur të pastër jetën shqiptare me të gjitha doket dhe zakonet, është ruajtur edhe gjuha. Nuk është e rastit që grekët e vjetër, Trojën e qanin ILLION, fjalë e ilirishtes që na kujton togfjalëshin “YLLI JONË”, dhe vetë emërtimi “ylliri”, na kujton togfjalëshin “YLLI I RI”. Si luftëtarë që shquheshin me besnikërinë dhe sidomos me trimërinë e tyre, ilirët arritën madje edhe në postet më të larta të Perandorisë së Romës. Shumë prej ilirëve qenë perandorë të shkëlqyeshëm të Romës dhe Bizantit, siç ishin Diokleciani, Trojani në kohën e të cilit Perandoria e Romës arriti zgjerimin e saj më të madh territorial, Konstantini që themeloi Stambollin e sotëm, Justiniani i I-rë dhe i II-të e të tjerë. Ende edhe sot ruhet në Grykën e Gjerdapit, buzë Danubit tabloja madhështore e gdhendur në shkëmb: “TABULLA TRAJANA”, si dëshmi e lavdisë së tij. Edhe në Perandorinë Osmane, shqiptarët kishin arritur postet më të larta shtetërore e ushtarake pas sulltanëve. Gjeneralët më të shquar osmanë në tokë e në det, ishin “arnautët” - siç i përcmonin shqiptarët. Shumë prej tyre, qenë vezirë të mëdhenj e kryekomandantë ushtarakë, “se-rasqer” siç i quanin turqit, dhëndurë sulltanësh e deri të pushtuesi i kryeqytetit të Bizantit, MEHMET PASHË ZOGJANI i Vushtrisë apo “ZAGANOS PASHA” - siç ia deformon mbiemrin, kronikani grek i sulltan Mehmetit II. Gjatë zhvillimit të mëtejshëm ekonomiko-shoqëror të shoqërisë ilire dhe kalimit në periudhën në të cilën ky popull zuri të quhet Arbër, atdheu i tyre Arbëri, ndërsa e folura e tyre: gjuhë e Arbrit, arbërisht, Besa, veç tipareve morallo - etike, zuri të marrë edhe tipare të qenësishme të detyrimit juridik popullor. Ajo u bë një mekanizëm i mbrojtjes kolektive në kthesat e mëdha e të rëndësishme historike për kombin e Atdheun tonë. Luftërat mijëvjeçare për liri e përparim në njërën anë dhe, veprat e tyre shkatërruese të pushtuesve barbarë kundër qytetërimit ilir në anën tjetër, na kanë hequr mundësinë t’i kemi burimet tona historike, kështu që, ne nuk kemi një pasqyrë të plotë të besëlidhjeve. Megjithatë, BESËLIDHJA E ARBËRISË (1257-1259) hetohet nga përshtkrimet që komandanti i forcave bizantine, Gjergj Akropoliti i bën Kryengritjes së Arbërisë. Përballë besëlidhjes së fuqishme të Arbërisë, popullsia e së cilës, siç shkruan ai, mori pjesë si një tërësi, bëri që ai, Gjergj Akropoliti, të binte rob në duart e burrave të Arbrit, të cilët ia dorëzuan despotit të Epirit, MI-

HAILIT II, ENGIJËLL KOMNENI. Burrat e Arbrit morën pjesë edhe në dy beteja të rëndësishme të koalicionit të krishterë ballkanik, por që të dyja dështuan. Është e rëndësishme të përmendet këtu se të dyjave u prinin në Betejën e Maricës (1371) VU-KASHINI dhe UGLESJA, ndërsa në Betejën e Kosovës, LLAZARI, që të tre, princa serbë. Lidhur me këtë fakt, propaganda e shfrenuar serbomadhe, mohon pjesëmarrjen e shqiptarëve ashtu si akademikët serbë që i kanë shitur penat e tyre në shërbim të politikës që shkojnë aq larg, sa falsifikojnë historinë dhe mohojnë pjesëmarrjen e shqiptarëve duke i trajtuar ato beteja si beteja serbo-turke. Mirëpo, fatmirësisht, shkencën botërore nuk e bëjnë serbët. Kronikanët osmanë, ASHIK PASHA ZADE dhe IDRIZ BITLISI, si dhe shkencëtarit austriak, JOSIF VON HAMMER, mbase ndër njohësit më të mirë të Perandorisë Osmane të asaj kohe, dëshmojnë me fakte se në Betejën e Maricës mori pjesë me shqiptarët e tij edhe sundimtari i Vlorës, ALEKSANDRI. E ndërsa nën komandën e Vukashinit dhe Ugleshës ishin 60 000 luftëtarë, komandanti turk Evrenoz Beu kishte vetëm 15 000 dhe ngadhënjëu. Autorët e përmendur tregojnë se, në Betejën e Kosovës (1389) veç polakëve, hungarezëve, çekëve, boshnjakëve, serbëve, kroatëve, rumunëve e bullgarëve, morën pjesë edhe shqiptarët. Madje ata patën komandantët e shkëlqyer Dimitër Jonimën, Gjergjin II, Shtatmir BALLSHËN (sllavët e quajnë: Stratimiroviç?!), vëllezërit JUNT dhe TEODORI II MUZAKA, që mbeti në fushën e nderit, GJERGJ KASTRIOTI I (gjyshi i Skënderbeut) dhe NIKOLLË DUKAGJINI I. Luftëtarit dhe prijësi trim shqiptar, MILLOSH NIKOLLA i fshatit të sotëm Kopiliq të Drenicës, arriti madje të shpojë me shpatë sulltanin turk, GAZI MURAT HANIN I. Këtë vepër heroike, mundohet ta përvetësojë duke e quajtur serb me emrin MILLOSH OBILIQ (prej Meziše, principatë që përfshinte Drenicën, pra Mëzi i pelës që ata e përkthejnë nga osmanishtja si “Kobilq” e mandej e heqin rrënjën e “K” nishtëtare duke mbetur Obiliq, zbërthim sipas Anatasie Urosheviqit, një ndër shkencëtarët më anti-shqiptarë që ka pasur ndonjëherë Serbia. Po s’është për t’u habitur se çdo gjë të lavdishme shqiptare, ata mundohen ta paraqesin si serbe, siç vijnë në nënën e Skënderbeut: VJOSA (emër peme e fruti, shqip), e cila pasi kishte kaluar në fenë ortodokse u quajt VO-JSAVA. Po në këtë mënyrë përvetësuar MANASTIRIN E DEÇANIT e të GRAÇANICËS të Mehmetit II të “FATIH”, dhe, kjo pasi kisha ortodokse u shpall vasale e sulltanit dhe meqë nëna e tij ishte serbe, u dha privilegje të mëdha. Por, BESËLIDHJA më e rëndësishme e kombit shqiptar është pa dyshim ajo e vitit 1444 dhe që nuk humbet asgjë nga shkëlqimi i saj. Më 2 mars të vitit 1444, në këtë qytet të mrekulluar, pra në Lezhën tonë famëmadhe, u mbajt KUVENDI I PRINCAVE të Arbrit, udhëhequr nga GJERGJ KASTRIOTI - Skënderbeu dhe nën kryesinë e tij, lidhën besën ANDREA TOPIA, GJERGJ ARIANITI, NIKOLLË PAL DUKAGJINI, LEKË ZAHARIA, GJERGJ STRES BALSJA, LEKË DUSHMANI, PJETËR SPANI e të tjerë. Përballë rrezikut të sërishtëm nga turqit, princat i lanë në një anë mospajtimet dhe grindjet dhe i bashkuar forcat politike, ekonomike e ushtarake nën pushtetin e BESËLIDHJES SË LEZHËS, e cila duke i bërë ballë superfuqisë më të madhe të kohës për një çerek shekulli, u bë MBU-ROJA më e sigurt për Europën e krishterë dhe qytetërimin e saj që e shpëtoi nga pushtimi osman. Për hir të sakrificës sublime dhe, aq më shumë, GJAKUT që derdhi Shqipëria me Gjergj Kastiotin, Europa sot ka për detyrë nderi të mos e pengojë, por, të ndihmojë përpjekjet titanike të kombit shqiptar për ÇLIRIM dhe RIBASHKIM E PËRPARIM. Situatën në Ballkan do ta stabilizojë vetëm RIBASHKIMI i të gjitha viseve etnike shqiptare në një shtet integral shqiptar. Hapi i parë drejt sendërtimit të këtij qëllimi fisnik dhe garanci se Europa nuk do të përsërisë gabi-

met e 1878-ës dhe të 1913-ës, është njohja e Republikës së Kosovës dhe e viseve të saj etnike që kanë qenë nën ish-Jugosllavi, si shtet i pavarur e sovran. Kultivimi dhe ruajtja e tipareve morale e juridike të besës gjatë tërës mesjetës, lidhet bashkëputshmërisht me kushtet e veçanta historike në të cilat u zhvillua shoqëria shqiptare deri në shekullin XX. Veç rregullimit të marrëdhënieve vetjake, familjare, gjinore e fisnore, sidomos në rrethanat e bashkësive patriarkale të fshatarësisë shqiptare, besa u bë edhe mekanizëm i veçantë mbrojtës në shkallë krahinore e gjithëkombëtare. Në dallim prej fshatarësisë së popujve të tjerë ballkanikë, në sajë të besëlidhjes, vetëm ajo shqiptare nuk u bë raja ose shërbëtoe. Malësorët shqiptarë ishin në për-plasje të vazhdueshme me administratën shtetërore, sepse ajo u përkiste pushtuesve të huaj. Besëlidhjet, pra, u shërbenin kryengritjeve për çlirim kombëtar e shoqëror dhe ishin një forcë e madhe lëvizëse drejt qytetërimit e përparimit. Funkzioni rregullator i besës e i besëlidhjes apo i futjes në besë, u vërejt sidomos në rastet e shpeshta të vrasjeve e të gjakmarrjeve, kësaj plage shekullore që në trojet e Arbrit e mbollën të huajt. Besa pengonte gjakderdhjen e gjakmarrjen dhe, në atë fazë zbuste veprimin e pakushtëzuar të këtij zakoni të egër, mbetur apo trashëguar nga pushtuesit e huaj barbarë. Funkzioni në këtë mënyrë i besës e i besëlidhjes, gjeti shprehjen më të mirë në rastet kur rrezikohet atdheu ose ndonjë pjesë e veçantë e tij. Në këtë mënyrë, organizoheshin kuvendet me popullin, nëpër të cilat sipas traditës së lashtë shqiptare, njerëzit “hynin në besë” me njëri-tjetrin, siç hynin edhe fshatra, qytete e krahina të tëra e deri në “besën e madhe”, e cila shtrihej në shkallë gjithëkombëtare me çdo rast shpallej BESËLIDHJA dhe rrokeshin armët për mbrojtjen e vendit. E ndërsa në vendet e tjera për rastet e ngjashme, mobilizimi bëhej me urdhër prej së larti nga perandori, mbreti apo princi, në Shqipëri, kjo ndodhte së poshtmi, mbi bazën e vullnetit të lirë me hyrjen në besë, e cila obligonte më shumë se çdo urdhër apo ligj. Besëlidhja, pra nuk ishte organizëm shtetëror, por zotim nderi e vullnetar për të qëndruar në ballë të luftës për mbrojtjen e vendit nga kërcënimet. Ajo kishte karakter mbrojtës. Kështu, në vitet ‘20 të shekullit të kaluar, nën kryesinë e Ismail pashë Vlorës, gjyshtit të Ismail Qemalit, lidhën besën ZYLYFTAR PODA, SHAHIN DEL-VINA, ÇELO PICARI, TAFIL BUZI, ABDYL KOKA e shumë atdhetarë të tjerë trima, të shoqëruar nga 7 000 besnikë syapatrembur e të armatosur të cilët organizuan më 7 nëntor 1828 në Berat, Kongresin apo “KUVENDIN E MADH SHQIPTAR”, prej të cilit, siç dëshmojnë burimet osmane të “Bashballkanlek Arshivi” -t të Stambollit, doli “Besëlidhja e fuqishme SHQIPTARE”. SADRI-AZEMI i Portës së Lartë dhe serasqer i Rumelisë, MEHMET RASHIT PASHA, i shkruan sulltanit më 21 nëntor 1828 se shqiptarët “nuk çajnë kokën për fe”, “din”, e “dovlet” se ky popull “nuk mund të krahasonet me burrëri e trimëri me asnjë komb tjetër”. Po kështu, një besëlidhje e rëndësishme, pas vrasjes me të pabesë të Ismal Pashë Vlorës, bëri ZYLYFTAR PODA me BUSHATËT e Shkodrës, më 1830. Mirëpo formën më të mirë, shtrirjen më të gjerë dhe përmbajtjen më të shëndoshë, besëlidhja e arriti me “Besëlidhjen Shqiptare të Prizrenit”, kur “hyrja në BESË”, u bë rreth një platforme të vetme politike; BASHKIMIT të katër vilajeteve shqiptare (krahinave), Shkodrës, Kosovës, Manastirit e Janinës në një shtet të bashkuar shqiptar. Kjo u arrit më 10 qershor 1878 në Prizren, si “kërbthizë e atdheut”, me besëlidhjen gjithëkombëtare, për t’i dalë zot copëtimit të atdheut, që ishte i kërcënuar me Traktatin e Shën Stefanit, paralagje e Stambollit. Kongresi i Berlinit, sado që nuk ia hapi dyert besëlidhjes shqiptare, të shndërruar në organizëm pushtetar, nuk mundi ta kapërcente çështjen shqiptare si një problem kyç. Deri atëherë, nuk kishte ndodhur që ndonjë fuqi sado e madhe të ketë qenë, të thyente vendimet e një Kongresi (kuvendi) botëror të paqes, mirëpo “BESËLIDHJA SHQIPTARE”. ME FORCËN USHTARAKE QË KRIJOI PREJ 200 000 LUFTËTARËSH TRIMA VULLNETARË, E DETYROI KONGRESIN E BERLINIT QË TRI HERË TË KORRIGJONTE VENDIMET E TIJ. Mbrojtja e shkëlqyer që shqiptarët i bënë Plavës e Gucisë, Hotit e Grudës, bënë të thyhej miti i “pathyeshmërisë së ushtrisë malazeze”, të Krijaz Nikollës, kur 8 000 shqiptarë me armatim shumë më të dobët, thyen me turp 12 000 ushtarë malazezë të armatosur me armët më moderne që u dhanë Fuqitë e Mëdha, flota e të cilave e sulmoi Ulqinin dhe së bashku me ushtrinë osmane ia dha Malit të Zi. Si vazhdim i natyrshëm i kësaj besëlidhje ishte edhe “LIDHJA SHQIPTARE” e Pejës me Haxhi Zekën, e cila u quajt: “BESA - BESË”. Bërthama e saj, nxorri krye qysh më 1893, kur Haxhi Zeka shkoi në Stamboll që t’ia paraqiste kërkesat e shqiptarëve, Sulltanit, por, u arrestua me të pabesë dhe u mbajt për tre vjet me radhë në internim. Pas kthimit, Haxhi Zeka organizoi popullin dhe më 1899, i dha karakter gjithëkombëtar Lidhjes “Besa-Besë” dhe e udhëhoqi me sukses atë derisa më 18 shkurt 1902, e vrau pabesisht, agjenti i Serbisë dhe i sulltanit. Besa është ajo që na identifikon me kodin e saj në botën perëndimore e cila përballë këtij fakti është skeptike.



Raporti i fundit i EIGE mbi kontrollin shtrëngues dhe dhunën psikologjike në të gjithë Shtetet Anëtare të BE-së provon një përhapje të lartë. Megjithatë, kanë filluar të vendosen masat e shtuara kundër kriminalizimit. Megjithatë ka ende shumë për t'u bërë.

Çfarë është kontrolli shtrëngues dhe dhuna psikologjike? Shpjegimet e mëposhtme karakterizojnë natyrën e të dyja formave të abuzimit.

- Kontrolli shtrëngues përkufizohet si “një kurs strategjik i sjelljes shtypëse që karakterizohet zakonisht nga abuzimi fizik dhe detyrimi seksual i shpeshtë, por i nivelit të ulët, në kombinim me taktikat për të frikësuar, degraduar, izoluar dhe kontrolluar viktimat” (Stark, 2013).

- Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit, neni 33) e përkufizon dhunën psikologjike si “çdo sjellje e qëllimshme që dëmton seriozisht integritetin psikologjik të një personi tjetër nëpërmjet shtrëngimit ose kërcënimit”.

Siç qëndron, statistikën janë grumbulluar në një realitet të zymtë. Të dhënat nga Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore (FRA) treguan se në të gjithë BE-në, 44% e grave kanë përjetuar dhunë psikologjike nga një partner gjatë jetës së tyre.

EIGE rekomandon që në mënyrë specifike, eksplicite dhe gjithëpërfshirëse të trajtohet dhuna psikologjike si një fenomen i pavarur. Ai gjithashtu kërkon të përfshijë një dimension dixhital në kuadrin e parandalimit dhe reagimit që synon viktimat e abuzimit në internet, si dhe të sigurojë që praktikën të arrijnë grupet më të rrezikuara dhe ata që kanë nevoja shtesë.

Në hulumtimin e EIGE, gratë më të reja (nën 30 vjeç), gratë me aftësi të kufizuara ose gjendje të vështirë shëndetësore, gratë jo heteroseksuale dhe gratë me prejardhje emigrante përjetojnë dhunë psikologjike në një shkallë më të lartë se popullata e përgjithshme.

Implikimet e dhunës psikologjike dhe kontrollit shtrëngues janë thellësisht të thella tek gratë viktimat, ku rreziku i vetëvrasjes, depresionit dhe çrregullimit të stresit post-traumatik (PTSD) janë veçanërisht të përhapura.

Për më tepër, ndikimi negativ tek fëmijët e viktimave mund të jetë i thellë dhe mund të çojë në një rrezik të shtuar të viktimizimit dhe kryerjes më vonë në moshën madhore.

Tani, në epokën e dominimit dixhital, disa shtete anëtare po marrin parasysh ndikimin psikologjik të dhunës kibernetike. Në Itali, përdorimi i komunikimit elektronik është një rrethanë rënduese për ndjekjen dhe, në Francë, një rrethanë rënduese për ngacmimet seksuale. Në Austri, përndjekja kibernetike përmendet veçanërisht si një formë e ndjekjes në kodin penal.

Luftimi i kontrollit shtrëngues dhe dhunës psikologjike vjen me një mori sfidash, duke pasur parasysh barrierat për parandalimin efektiv. Për 28% të praktikuesve të anketuar nga EIGE për



këtë projekt, mungesa e njohurive mbi dhunën psikologjike mbetet pengesa më e rëndësishme për parandalimin. Si rezultat, viktimat e kontrollit shtrëngues dhe dhunës psikologjike hezitojnë të raportojnë përvojat e tyre.

Nga këndvështrimi ligjor, në shumicën e shteteve anëtare të BE-së dhuna psikologjike ndiqet penalisht për

vepra penale që nuk janë specifike për kontekstin e familjes ose të partnerit intim. Danimarka, Spanja, Franca, Hungaria dhe Irlanda kanë zbatuar vepra penale specifike për dhunë psikologjike ose kontroll me forcë. Dhe vetëm Danimarka dhe Irlanda përdorin gjuhën e kontrollit shtrëngues në legjislacion.



Komisioni European paraqet Axhendën e re Europiane të Inovacionit

Komisioni miratoi një Agjendë të Re Europiane të Inovacionit për ta pozicionuar Europën në ballë të valës së re të inovacionit të thellë të teknologjisë dhe bizneseve fillestare. Ai do të ndihmojë Europën të zhvillojë teknologji të reja për të adresuar sfidat më urgjente shoqërore dhe për t'i sjellë ato në treg. Axhenda e Re Europiane e Inovacionit është krijuar për të pozicionuar Europën si një lojtar kryesor në skenën globale të inovacionit. Europa dëshiron të jetë vendi ku talentet më të mira punojnë krah për krah me kompanitë më të mira dhe ku lulëzon inovacioni i thellë i teknologjisë dhe krijon zgjidhje inovative të reja në të gjithë kontinentin që do të frymëzojnë botën.

Duke udhëhequr në inovacion, veçanërisht në valën e re të inovacionit të teknologjisë së thellë që kërkon Kërkim dhe Zhvillim dhe investime të mëdha kapitale, Europa do të përforcojë rolin e saj qendror në formësimin e tranzicionit të gjelbër dhe dixhital. Inovacioni i thellë i teknologjisë do të përforcojë lidhshirësinë teknologjike të Europës dhe do të gjenerojë zgjidhje novatore për sfidat urgjente shoqërore, të tilla si ndryshimet klimatike dhe kërcënimet kibernetike. Risi të tilla ka të ngjarë të ujitin dhe të përfitojnë të gjithë sektorët, nga energjia e rinovueshme në agro-teknologji, nga ndërtimi të lëvizshmëria dhe shëndeti, duke trajtuar kështu sigurinë ushqimore, duke reduktuar varësinë nga energjia, duke përmirësuar shëndetin e njerëzve dhe duke i bërë ekonomitë tona më konkurruese. Pasojat e rënda të luftës së agresionit të Rusisë u kanë dhënë këtyre çështjeve një urgjencë edhe më të madhe dhe kanë nxitur ndryshime strategjike të politikave për të siguruar prosperitetin dhe sigurinë e BE-së.

Margrethe Vestager, Zëvendës-Presidente Ekzekutive për një Europë të përshtatshme për Epokën Dixhitale, tha: “Ne duhet të forcojmë ekosistemet tona të inovacionit për të zhvilluar teknologji me në qendër njeriun. Kjo Agjendë e re e Inovacionit bazohet në punën e rëndësishme të bërë tashmë mbi inovacionin në vitet e fundit dhe do të na ndihmojë të përshejmë tranzicionin tonë dixhital dhe të gjelbër. Axhenda i ka rrënjët në sferat dixhitale, fizike dhe biologjike dhe do të na mundësojë të trajtojmë shqetësimet më të ndezura, të tilla si ndërprerja e varësisë nga lëndët djegëse fosile ose sigurimi i furnizimit tonë me ushqim në një mënyrë të qëndrueshme.”

Mariya Gabriel, Komisionerja për Inovacionin, Kërkimin, Kulturën, Arsimin dhe Rininë, tha: “Axhenda e re Europiane e Inovacionit do të sigurojë që novatorët, bizneset e tyre novatore të bëhen liderë globalë të inovacionit. Për më shumë se një vit ne kemi konsultuar palët e interesuara, si drejtuesit e ekosistemit të inovacionit, startup-et, gratë themeluese, gratë që punojnë në sipërmarrjen kapitale, universitetet dhe bizneset. Së bashku, ne do ta bëjmë Europën fuqinë globale për inovacionet e teknologjisë së thellë dhe startup-et.”

Duke u mbështetur në mendësinë sipërmarrëse të europianëve, përsosmërinë shkencore, fuqinë e tregut të vetëm dhe të shoqërive demokratike, Axhenda e Re e Inovacionit në veçanti do të:

- Përmirësojë aksesin në financa për bizneset fillestare dhe të shkallëzuara europiane, për shembull, duke mobilizuar burime të pashfrytëzuara të kapitalit privat dhe duke thyeshuar rregullat e listimit;



Sindikata Shëndetësore: HERA ofron listën e 3 kërcënimeve më të mëdha shëndetësore kundër të cilave duhet të përgatitemi

Autoriteti i Komisionit për Gatishmërinë dhe Reagimin ndaj Emergjencave Shëndetësore (HERA) paraqet një listë prioritarë të 3 kërcënimeve shëndetësore që kërkojnë koordinim në nivel të BE-së për përgatitjen e kundërmasave mjekësore. Bordi i HERA-s ra dakord për një listë që përfshin tre kategori kërcënimesh të potencialit të rrezikshëm për jetën ose të dëmshme, të cilat mund të përhapen në të gjithë Shtetet Anëtare: patogjenë me potencial të lartë pandemik; kërcënimet kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore; dhe kërcënimet që vijnë nga rezistenca antimikrobike. Stella Kyriakides, Komisionerja për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore, tha: “Për herë të parë, ne paraqesim kërcënimet kryesore shëndetësore për të cilat duhet të përgatitemi dhe të punojmë për t'iu përgjigjur. Ky ushtrim është hapi i parë për të siguruar që kundërmasat mjekësore mund të vihen në dispozicion dhe të jenë aksesueshme për të gjitha shtetet anëtare me shpejtësi kur të jetë e nevojshme. HERA është ngritur si kulla jonë e vrojtimit për urgjencat e ardhshme shëndetësore dhe jam i kënaqur që tani po fillon dukshëm ta përmbushë këtë mision. Identifikimi i kërcënimeve kryesore për sigurinë tonë shëndetësore nis procesin për të siguruar zhvillimin, kapacitetin e prodhimit dhe shkallëzimin e prodhimit, prokurimit dhe grumbullimit të mundshëm të produkteve medicinale, diagnostifikimit, pajisjeve mjekësore dhe pajisjeve mbrojtëse personale, si dhe kundërmasave të tjera mjekësore, për të siguruar disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë e tyre në rast nevojë.”

Përmirësimi i kushteve për t'i lejuar novatorët të eksperimentojnë me ide të reja përmes kutive të rërës rregullatore;

- Do të ndihmojë në krijimin e “luginave rajonale të inovacionit” që do të forcojnë dhe do të lidhin më mirë lojtarët e inovacionit nëpër Europë, duke përfshirë rajonet që mbeten prapa;

- Do të tërheqë dhe ruajë talentet në Europë, për shembull duke trajnuar 1 milion talente të teknologjisë së thellë, duke rritur mbështetjen për gratë novatore dhe duke inovuar me opsionet e aksioneve të punonjësve fillestarë;

- Do të përmirësojë kornizën e politikave përmes terminologjisë, treguesve dhe grupeve më të qarta të të dhënave, si dhe mbështetjes së politikave për Shtetet Anëtare.

Axhenda e Re Evropiane e Inovacionit përcakton 25 veprime të dedikuara nën pesë fusha orientimi:

- Financimi i “Scale-Ups” do të mobilizojë investitorë institucionalë dhe privatë të tjerë në Europë për të investuar dhe për të përfituar nga përshkallëzimi i sipërmarrjeve të reja europiane të teknologjisë së thellë.

- Mundësimi i inovacionit përmes hapësirave të eksperimentimit dhe prokurimit publik do të lehtësojë inovacionin përmes kushteve të përmirësuar të kornizës, duke përfshirë qasjet eksperimentale ndaj rregullimit (p.sh. kutitë rregullatore të rërës, shtretërit e testimit, laboratorët e jetesës dhe prokurimet e inovacionit).

- Përsheptimi dhe forcimi i inovacionit në Ekosistemet Europiane të Inovacionit në të gjithë BE-në do të mbështesë krijimin e luginave rajonale të inovacionit dhe do të ndihmojë Shtetet Anëtare dhe rajonet të drejtojnë të paktën 10 miliardë euro për projekte konkrete inovative ndër-rajonale, duke përfshirë inovacionin e teknologjisë së thellë për prioritetet kyçe të BE-së. Ai gjithashtu do të mbështesë Shtetet Anëtare për të nxitur inovacionin në të gjitha rajonet përmes përdorimit të integruar të politikës së kohezionit dhe instrumenteve të “Horizon Europe”.

- Nxitja, tërheqja dhe mbajtja e talentëve të thella të teknologjisë do të sigurojë zhvillimin dhe rrjedhën e talentëve thelbësorë të teknologjisë së thellë brenda dhe drejt BE-së përmes një sërë iniciativash, duke përfshirë një skemë praktike inovacioni për startup-et dhe ndërmarrjet në shkallë të gjerë, një grup talentesh të BE-së për të ndihmuar startup-et dhe inovatorët. bizneset gjejnë talente jashtë BE-së, një skemë sipërmarrjeve dhe lidhshirësi të grave dhe një punë pioniere në opsionet e aksioneve të punonjësve të startup-eve.

- Përmirësimi i mjeteve të bërjes së politikave do të jetë çelësi për zhvillimin dhe përdorimin e grupeve të të dhënave të fuqishme, të krahasueshme dhe përkufizimeve të përbashkëta (startup-e, shkalla e rritjes) që mund të informojë politikën në të gjitha nivelet në të gjithë BE-në dhe për të siguruar një koordinim më të mirë të politikave në nivel evropian përmes Forumit të Këshillit European të Inovacionit.

Duke u mbështetur në punën thelbësore që është bërë tashmë për të nxitur inovacionin në BE, Axhenda e Re Europiane e Inovacionit synon të përshpejtojë zhvillimin dhe shkallëzimin e inovacionit në të gjithë Bashkimin European nëpërmjet një grupi veprimesh koherente.

Besimi në informacionin e rremë është një shqetësim i shëndetit mendor

Është lajm i rremë (“fake”) apo “fakt”? Faktet mund t’ju duken dëshpëruese, por nëse keni probleme të shëndetit mendor si ankthi dhe depresioni, jeni më të prirur të besoni atë çfarë është e rreme.

Një studim ka zbuluar se njerëzit që besojnë në informacione të rreme për pandeminë e koronavirusit kanë më shumë gjasa të vuajnë nga simptomat e ankthit dhe depresionit.

“Studimi ynë tregon ndikimin e mundshëm negativ të besimeve të rreme rreth COVID-19 në shëndetin mendor”, - thotë studiuesi kryesor i studimit, Pawel Debski.

Por studimi nuk tregon se simptomat e depresionit dhe ankthit drejtojnë drejtpërdrejt besimin në informacionin e rremë. As nuk jep shpjegime se si besimi në informacionin e rremë mund të shkaktojë vështirësi në shëndetin mendor.

Informacioni i rremë është dëshpërues

Duke përdorur dy pyetësorë në internet: “Shkalla e Besimeve Konspirative COVID-19” dhe “Shkalla e Ankthit dhe Depresionit Spitalor”, studiuesit kërkuar korrelacione midis besimeve të rreme dhe kushteve të shëndetit mendor.

Ata thonë se zbuluan se besimet e zakonshme të rreme për pandeminë përfshinin idetë se qeveritë e ekzagjeruan numrin e vdekjeve nga COVID-19, se 5G përhap koronavirusin dhe se mbajtja e një maske shkakton mungesë oksigjeni dhe helmim nga dioksidi i karbonit.

Pandemia goditi rëndë shëndetin mendor

Ekspertët e kanë përshkruar pandeminë si një krizë në shëndetin mendor.

Organizata Botërore e Shëndetësisë raporton se çështjet e shëndetit mendor u rritën në të gjithë botën për shkak të koronavirusit dhe kufizimeve të sjella për të frenuar përhapjen, siç janë bllokimet dhe karantinimet.

Depresioni dhe ankthi u rritën me 25% në vitin e parë të pandemisë, me të rinjtë dhe gratë që shfaqnin rritjen më të madhe të simptomave.

Thuhej se izolimi social dhe ankthi për shëndetin e dikujt dhe të të dashurve ishin ndër faktorët më të mëdhenj të stresit. Punëtorët kryesorë si profesionistët e kujdesit shëndetësor përmendën gjithashtu gjendjen e lodhjes së skajshme si ndikim në shëndetin e tyre mendor.

Dhe ata thonë se zbuluan gjithashtu se depresioni kishte një lidhje të lartë me besimin në informacionin e rremë për pandeminë, ndërsa ankthi ishte i lidhur më mesatarisht.

Studimi sugjeroi korrelacione të larta midis besimit në informacionin e rremë pandemik dhe besimit në teoritë më të gjera të konspiracionit.

Hulumtimet nga shoqata bamirëse e shëndetit mendor, me bazë në Mbretërinë e Bashkuar, “Mind”, sugjerojnë se njerëzit që luftuan me shëndetin e tyre mendor përpara fillimit të pandemisë ishin më të prekur nga kufizimet dhe bllokimet.

A janë mediat sociale fajtoare për lajmet e rreme rreth COVID-19?

Më shumë se gjysma e europianëve besojnë se janë ekspozuar ndaj dezinformatare në internet, sipas një raporti të publikuar nga Komisioni Europian.

Pandemia pa përdorimin e mediave online dhe sociale në nivelet më të larta të të gjitha kohërave, sipas hulumtimit nga “Statista”, dhe një studim në revistën “Science” sugjeron që informacioni i rremë arrin më shumë njerëz sesa informacioni faktik në mediat sociale.

Është një fenomen që psikologët e quajnë “paragjykim negativ”. Ndodh kur njerëzit përqendrohen në atë që është potencialisht e dëmshme dhe jo në atë që është e dobishme.

Dhe teoria është se përqendrimi në informacione negative i përkeqëson simptomat e depresionit, dhe kjo nga ana tjetër nxit besimin e mëtejshëm në informacionin e rremë.

Mbështetja e shëndetit mendor nevojitet për t’i mbajtur gjërat faktike

Studimi sugjeron se besimi në teoritë e konspiracionit u bën thirrje njerëzve, nevojat kryesore psikologjike të të cilëve janë të paplotësuara, siç është ndjenja e kontrollit mbi jetën e dikujt. Për shembull, njerëzit që ndihen të pafuqishëm në jetën e tyre mund të përdorin informacion të rremë si një mënyrë për të kontrolluar atë që besojnë.

“Ne mendojmë se besimi në informacionin e rremë kontribuon në një ndjenjë të dobësuar sigurie, duke shkaktuar zhvillimin e ankthit dhe depresionit”, - thotë Debski.

Por, sipas shoqatës “Mind”, mbështetja e njerëzve me informacion të besueshëm për vetë shëndetin mendor do të ndihmonte.

“Ne hasim shumë keqkuptime rreth shëndetit mendor çdo ditë në media dhe në internet”, - thotë zëdhënësi i Mind, Stephen Buckley. “Trajtimi i qëndrimeve negative është çelësi për reduk-

Hulumtimi i ri lidh besimin në lajmet e rreme për COVID-19 me ankthin dhe depresionin. A mundet që kujdesi më i mirë për shëndetin mendor të zvogëlojë përhapjen e informacionit të rremë?



timin e stigmës, e cila mund të ndihmojë për të luajtur një rol në adresimin e izolimit social dhe ndjeshmërisë së mundshme ndaj lajmeve të rreme.”

Pra, mbështetja e njerëzve përmes çështjeve të shëndetit mendor mund t’i ndihmojë ata të ndërtojnë besim në informacionin faktik.

Dhe kjo mund të jetë veçanërisht e vërtetë, thotë Buckley, për njerëzit me prejardhje etnike të zezë dhe të pakicave, ose njerëzit që jetojnë në varfëri, të cilët kanë gati dy herë më shumë gjasa të përdorin komunitetet në internet për të marrë informacion rreth shëndetit të tyre mendor. Është thelbësore që ne t’i sigurojmë që këto hapësira të jenë të sigurta, të besueshme dhe me reputacion.”

NASA

“James Webb” i NASA-s zbulon shkëmbinjtë kozmikë, peizazhin vezullues të lindjes së yjeve

Ky peizazh “malesh” dhe “luginash” të njollosura me yje vezullues është në të vërtetë skaji i një rajoni yje-formues aty pranë të quajtur NGC 3324 në mjegullnajën Carina. I kapur në dritën infra të kuqe nga teleskopi i ri hapësinor James Webb i NASA-s, ky imazh zbulon për herë të parë zona të padukshme më parë të lindjes së yjeve.

Të quajtur Shkëmbinjtë Kozmikë, fotografia në dukje tre-dimensionale e Uebit duket si male të thepisura në një mbrëmje me hënë. Në realitet, është skaji i zgavrës gjigante, të gaztë brenda NGC 3324, dhe “majat” më të larta në këtë imazh janë rreth 7 vite dritë të larta. Zona e kavernave është gdhendur nga mjegullnaja nga rrezatimi intensiv ultravjollcë dhe erërat yjore nga yjet jashtëzakonisht masivë, të nxehtë dhe të rinj të vendosur në qendër të fluskës, mbi zonën e treguar në këtë imazh.

Rrezatimi fluskues ultravjollcë nga yjet e rinj po skalit murin e mjegullnajës duke e gërryer ngadalë. Shtyllat gjigande ngrihen mbi murin e ndezur të gazit, duke i rezistuar këtij rrezatimi. “Avulli” që duket se ngrihet nga “malet” qiellore është në të vërtetë gaz i nxehtë, jonizues dhe pluhur i nxehtë që largohet nga mjegullnaja për shkak të rrezatimit të vazhdueshëm.

“Webb-i” zbulon çerdhe yjore në zhvillim dhe yje individualë që janë plotësisht të fshehur në fotot e dritës së dukshme. Për shkak të ndjeshmërisë së “Webb-it” ndaj dritës infra të kuqe, ai mund të shikojë përmes pluhurit kozmik për të parë këto objekte. Rrymat prototyjore, të cilat shfaqen qartë në këtë imazh, dalin nga disa prej këtyre yjeve të rinj. Burimet më të reja shfaqen si pika të kuqe në zonën e errët dhe me pluhur të resë. Objektet në fazat më të hershme e të shpejta të formimit të yjeve janë të vështira për t’u kapur, por ndjeshmëria ekstreme e “Webb-it”, rezolucioni hapësinor dhe aftësia e imazhit mund të përshkruajnë këto ngjarje të pakapshme.

Këto vëzhgime të NGC 3324 do të hedhin dritë mbi procesin e formimit të yjeve. Lindja e yjeve përhapet me kalimin e kohës, e shkakton nga zgjerimi i zgavrës së gërryerjes. Ndërsa skaji i ndritshëm, i jonizuar lëviz në mjegullnajë, ai ngadalë shtyhet në gaz dhe pluhur. Nëse skaji ndeshet me ndonjë material të paqëndrueshëm, presioni i shtuar do të shkaktojë që materiali të shembet dhe të formojë yje të rinj.

Në të kundërt, ky lloj shqetësimi mund të parandalojë gjithashtu formimin e yjeve pasi materiali i krijimit të yjeve gërryhet. Ky është një ekuilibër shumë delikat midis formimit të yjeve të ndezjes dhe ndalimit të tij. Webb do të trajtojë disa nga pyetjet e mëdha dhe të hapura të astrofizikës moderne: Çfarë e përcakton numrin e yjeve që formohen në një rajon të caktuar? Pse yjet formohen me një masë të caktuar?

“Webb-i” do të zbulojë gjithashtu ndikimin e formimit të yjeve në evolucionin e reve gjigante të gazit dhe pluhurit. Ndërsa efekti i yjeve masive – me erërat e tyre të dhunshme dhe energjinë e lartë – është shpesh i dukshëm, dihet më pak për ndikimin e



yjeve më të shumtë me masë të ulët. Ndërsa formohen, këta yje më të vegjël krijojnë ngushtica kundër rrymave që mund shihen këtu, të cilët mund të injektojnë shumë vrull dhe energji në retë. Kjo redukton fraksionin e materialit mjegullnajës që mbjell yje të rinj.

Deri në këtë pikë, shkencëtarët kanë pasur shumë pak të dhëna për ndikimin e morisë së yjeve të rinj dhe më energjikë me masë të ulët. Me “Webb-in”, ata do të jenë në gjendje të marrin një regjistrim të plotë të numrit dhe ndikimit të tyre në të gjithë mjegullnajën.

I vendosur afërsisht 7 600 vite dritë larg, NGC 3324 u fotografua nga kamera me infra të kuqe afër (NIRCam) dhe Instrumenti me infra të kuqe të mesme (MIRI) të “Webb-it”.

NIRCam, me rezolucionin e tij të qartë dhe ndjeshmërinë e pashembullt, zbulon qindra yje të fshehur më parë, madje edhe galaktika të shumta në sfond.

Në këndvështrimin e MIRI-t, yjet e rinj dhe disqet e tyre me pluhur, që formojnë planetë, shkëlqejnë fort në infra të kuqe në mes, duke u shfaqur rozë dhe e kuqe. MIRI zbulon strukturat që janë të ngulitura në pluhur dhe zbulon burimet yjore të avionëve dhe rrjedhjeve masive. Me MIRI, pluhuri i nxehtë, hidrokarburet dhe përbërjet e tjera kimike në sipërfaqen e kreshtave shkëlqejnë, duke dhënë pamjen e shkëmbinjve të dhëmbëzuar.

NGC 3324 u katalogua për herë të parë nga James Dunlop në 1826. I dukshëm nga hemisfera jugore, ai ndodhet në cepin veriperëndimor të Mjegullnajës “Carina” (NGC 3372), e cila gjendet në yjesinë “Carina”. Mjegullnaja “Carina” është shtëpia e Mjegullnajës së “Vrimës së Çelësit” dhe yllit super-gjigant aktiv e të paqëndrueshëm të quajtur “Eta Carinae”.

Teleskopi Hapësinor “James Webb” është observatori kryesor i shkencës hapësinore në botë. “Webb” do të zgjidhë misteret në sistemin tonë diellor, do të shikojë përtej botëve të largëta rreth yjeve të tjerë dhe do të hetojë strukturat dhe origjinën misterioze të universit tonë dhe vendin tonë në të. “Webb” është një program ndërkombëtar i udhëhequr nga NASA me partnerët e saj, ESA (Agjencia Europiane e Hapësirës) dhe CSA (Agjencia Kanadeze e Hapësirës).

BESËLIDHJET E MALLAKASTRËS NË POÇEM, VLERË E ATDHETARISË SHQIPTARE

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Monument atdhetarie me rëndësi historike kombëtare

Besëlidhja e Poçemit është një kala shqiptarizme, një monumentet i rëndësisë historike kombëtare që shtrihet në tre epoka, në pothuaj një shekull (1847-1920-1943).

Në kuadër të kryengritjeve të trevës atdhetare të Mallakastrës, Besëlidhja e Poçemit zë vend të rëndësishëm jo vetëm për Mallakastrën por për mbarë shqiptarinë për vlerat e rëndësishme që formatoi në kohë pushtimi. Në shekullin e XVIII, Perandoria Osmane ndryshon sistemin e taksimit, duke rënduar edhe më tej vendet nën pushtim. Pikërisht këtë lloj taksimi e kundërshtuan fuqishëm fshatrat e lirë shqiptarë dhe bashkë me ta bashkohen edhe ish-oficerë që kishin shërbyer në shërbim të Perandorisë Osmane. Për të pasur një strukturë sa më të gjerë popullore u bë edhe një besëlidhje, që duke e parë në plan të përgjithshëm për të gjithë Vilajetet shqiptare. Por sikurse në Labëri, në Kuç e Mesaplik, në Fushëbardhë e Zhulat, në Sinjë e në mbarë Shqipërinë, Poçemi i Mallakastrës nuk është një vend i thjeshtë gjeografik, por është vendi i shenjtëruar i trevës së burrave të shquar, trima, të mençur, patriotë dhe atdhetarë deri në palcë, një vend pelegrinazhi i kujtesës historike të zonës, që me Besëlidhjen e parë të 1847-tës, që u pasua nga dy besëlidhje të tjera në periudha të mëvonshme historike, sikurse ishte ajo e motit të madh të 1920-tës dhe më tej e viteve të zjarra të Luftës së Madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare shqiptare të 1943-shit. Besëlidhjet e mëdha kishin një mision madhor: Idealin e lirisë, pavarësisë dhe dinjitet kombëtar. Prandaj nderohet dhe respektohet Mallakastra për kontributin e madh që ka dhënë në ngritjen e lavdisë së historisë së shqiptarëve nëpër shekuj. Shqipëria dhe mbarë shqiptarët janë të bekuar që kanë një krahinë patriotike, atdhetare dhe heroike si Mallakastra e tre besëlidhjeve të mëdha, të etiketuara tashmë si “Tre Besëlidhjet e Poçemit, në vitet 1847, 1920, 1943”, që janë në fakt besëlidhjet e frymëzim mbarëkombëtar për kryengritje mbarë popullore kundër pushtuesve të të gjitha ngjyrave e racave. Krahinat dhe vendet historike që kanë shkruar histori dhe kanë ngelur në memorien e kombit janë të shumta si Labëria, Peza, Dibra, Kosova, Kelmendi, Malësia e Gjakovës, Prizreni, Shkupi, Janina, Mirdita, Vlora, gjithë Shqiptaria, por emri i Mallakastrës sikurse shumë krahina të tjera në Shqipëri ngrihet madhërishtëm mbi djegiet e vrasjet e mizoritë e të gjitha pushtuesve, duke gjetur forca të ringrihet dhe të godasë energjikisht për të mbrojtur jetën, popullatën, krenarinë dhe dinjitetin kombëtar. Prandaj edhe mbarë Shqipëria dhe shqiptaria krenohet me një krahinë si

(Në përkujtim të tre epokave historike që ia lartësuan emrin dhe famën Mallakastrës dhe e bënë të njohur trimërinë, mençurinë dhe atdhetarinë mallakastrjote, në përkujtim të ngjarjeve epokale të 1847, 1920, 1943, të tre Besëlidhjeve në Poçemin historik, të zhvilluara 175 vjet më parë, 102 vjet më parë dhe 79 vjet më parë. Për këto besëlidhje të shenjtëruara meritojnë homazhin për trimat e rënë në luftë, nderimin më të thellë për gjakun e derdhur për liri dhe mirënjohje për ata burra që shkruan historinë me mençuri, jatagan, pushkë e penë në mbrojtje të Shqipërisë, shqiptarizms dhe interesit kombëtar shqiptar).

Mallakastra, sepse i ka dalë zot atdheut dhe kombit në momentet më të vështira të kërcënimeve të ekzistencës së tij.

Mallakastra ka qenë gjithmonë bashkë me Labërinë dhe Shqipërinë në luftë dhe në paqe, dhe nuk ia ka kursyer djemtë në betejat më të përgjakshme të historisë shqiptare. Jehona dhe rëndësia e Kuvendeve të Poçemit nuk i përkasin vetëm Mallakastrës, sepse janë besëlidhje historike të historisë së shqiptarëve, janë betime mbi flamur të kombit, fjalë burrash për liri mbarëkombëtare të të gjithë shqiptarëve. Në Mallakastër dhe jo vetëm flitet gjerësisht për korrikun e besëlidhjeve, që të bashkuar si rrallë herë në historinë e një vendi që tre kuvende burrash në të njëjtin shesh, në të njëjtin muaj dhe për të njëjtat motive, për luftë kundër pushtuesve të huaj, janë mbledhur dhe kanë dhënë besën. Poçemi është kthyer në spirancën ku është ankoruar trimëria dhe lufta për liri, është shenjtëruar nga vetë bijtë e bijat mallakastrjote dhe meriton përkujtim të përhershëm. Të nderosh e respektosh kuvendet e Poçemit është të nderosh dhe respektosh burrat e mëdhenj të kombit që jetën e shkrinë për Shqipërinë. Vlerat patriotike dhe atdhetare, sakrificat më sublimë të burrave dhe grave të Mallakastrës i kanë dhënë nder e lavdi historisë sonë kombëtare në shekuj dhe e rritën prestigjin shqiptar në arenën botërore.

Në jetojmë në saje të burrave të mëdhenj dëshmorë... shqiptarët aristokratët e Ballkanit

Për fatet e shqiptarëve në shekuj jo rrallë ka vendosur fushëbeteja. Bilanci shpesh është matur me “kutin” - trimëri, gjak e sakrificë sublimë deri sa është mbërritur në “Shqipërinë Londineze”, 110 vjet më parë vendimi për Shqipërinë merrej në Londër, atje ku afirmohej Shteti shqiptar. Por nuk mund të kishte afirmim kombëtar, pa Rilindje dhe Rilindas, pa Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, pa kryengritjet e shumta shekullore të shqiptarëve, pa çetat e lirisë, pa intelektualizmin dhe elitat e mençura që punuan me pushkë e penë për Shqipërinë, pa gjakun e derdhur të kapedanëve dhe dëshmorëve në shekuj. Mençuria shekullore e popullit tonë thotë: “Kombi që nuk i harron bijtë e tij të rënë në luftë, s’ka mort kurrë”. Histo-

ria e një kombi vlerësohet nga figurat e shquara që ai ka nxjerrë. Një komb që s’ka figura të shquara nuk ka as histori. Filozofi e historiani francez Hyppolyte (1828-1892) thotë: “Ne jetojmë në saje të burrave të mëdhenj dëshmorë dhe atyre u jemi mirënjohës. Në fakt na administrojnë të mëdhenjtë e vdekur”. Thellësia shpirtërore e dëshmorëve qëndron në sakrificën supreme për kombin. Sakrificat e të gjitha brezave janë bërë në emër të jetës, të zotërimit të së djeshmes, të tashmes dhe së ardhmes, në emër të jetës zot në fatin e vet. Një shkrimtar gjerman ka shkruar se “shqiptarët janë një popull zotërinjsh”; ndërsa një autor francez thotë se “shqiptarët janë aristokratët e Ballkanit. Ata kishin karakter të tillë që më mirë të pranonin të ndërronin fenë, se sa të hiqnin dorë nga synimet e ambicies së pareshtur për lirinë e rrënjësor thellë në shpirt”. Në shpirtin shqiptar ka jetuar e kaluara historike e shkruar në këngë, shpesh e pa dokumentuar, por e arkivuar thellë në memorien e kombit. Në prushin e zjarrtë të vargut popullor shqiptar në të katër anët e hapësirës shqiptare, gjen të trupëzuar epope të trimërive e të luftërave kundër pushtuesve. Kreshnikët dhe Kapedanët, prijësit e luftëtarët e lirisë i gjen në çdo varg dhe këngë, në gojëdhëna, në mite, legjenda, në çdo copëz të historisë shqiptare. Memorialët e dëshmorëve janë element i rëndësishëm historik, një emetues valësh, ngjarjesh të shquara e të paharruara, valë që përhapin jehonën e traditës shekullore luftarake shqiptare.

Çështja kombëtare dhe rezistenca e luftëtarëve mallakastriotë

Prijësi i kryengritjes fshatare anti-osmane të vitit 1847, Rrapo Hekali/Hasani lindi në një familje me origjinë nga fshati Hekal i Mallakastrës, me tradita të shquara luftarake. Në moshë fare të re u dallua për qëndresë kundër shtypjes kombëtare osmane. Si udhëheqës i kryengritjes së vitit 1847, krahas Zenel Gjolekës, Rrapo Hekali u shqua në luftërat për çlirimin e Beratit dhe të Greshicës. Pas shtypjes së kryengritjes nga një ekspeditë e madhe ushtarake osmane, Rrapo Hekali u kap në befasi në fshatin e Qesarat, dhe u

dërgua në Manastir bashkë me të vëllanë dhe dy djemtë si dhe 35 luftëtarë të tjerë besnikë të tij. Rrapo Hekalin e veshin me uniformë turke që të mos binte në sy të popullsisë nga frika e ndonjë revolte mbarëpopullore për kapëdanin e vet. Rrapo Hekali mbajti një qëndrim burrëror para komandantit të Rumelisë, në kazermën e famshme të Manastirit. Ai deklaroi që luftonte për çështjen kombëtare shqiptare. Sipas gojëdhënës popullore vdiq në natën e 31 dhjetorit të vitit 1847, në burgun e kazermës së Manastirit, i helmuar nga autoritetet osmane. Në fakt emri i vërtetë i Rrapo Hekalit ishte Rrapo Hasani. Pasi shërbeu për një kohë të gjatë si ushtarak në ushtrinë osmane në gadishullin arabik. Rrapo bëri karrierë ushtarake duke u graduar oficer, falë aftësive të tij në trimëri dhe në intuitë luftarake, duke u dalluar në mesin e luftëtarëve të tjerë. Kjo e ndihmoi të grumbullonte një farë pasurie. Me këto para, kur u kthye në atdhe bleu një çiflig në Levan të Fierit. Në fillimet e Tanzimatit, Rrapo Hekali u pozicionua si kundërshtar i tij. Fillimi i rekrutimit ushtarak dhe taksa e xhelepit, bëri që në maj të vitit 1847 të shpërthente kryengritja anti-osmane, ku ai luajti rol kryesor.

Dekreti i Shenjtë i Odës së Trëndafilave - Tanzimatit

Porta e Lartë vendosi të reformonte shtetin duke shpallur Tanzimatit. Për t’i bërë ballë zbatimit të Reformave të Tanzimatit që në fakt godisnin interesat e shqiptarëve. Krerët e Shqipërisë së Jugut u mbledhën në qershor të vitit 1847 në Mesaplik të Vlorës, ku u formua besëlidhja e përfaqësuesve të Shqipërisë së Jugut që u quajt “Lidhja Kombëtare Shqiptare”. Porta e Lartë e kishte kuptuar se një perandori e madhe, nuk mund të mbahej e bashkuar me pashallarë të shpërndarë që nga Ballkani e deri në Kaukaz, që të qeverisnin jashtë kontrollit. I nxitur edhe nga fuqitë e mëdha të kohës, Anglia dhe Franca, sulltan Abdyl Mexhidi shpalli një dekret i cili parashikonte përqendrimin e pushtetit, ngritjen e një sistemi gjyqësor sipas parimeve europiane, riorganizimin e sistemit të taksave dhe shërbimin ushtarak të detyrueshëm. Dekreti u quajt “Hati-Sherif

i Gjylhanesë” ose “Dekreti i Shenjtë i Odës së Trëndafilave”, të nëntorit të vitit 1839. Reformat e reja u quajtën me emrin e thjeshtë “Tanzimat”, që nga persishtja do të thotë “rend, rregull”. Në fakt Sulltani hezitoi disa vjet që ta zbatonte rendin e ri në Shqipëri. Fakt është se hapësira shqiptare nën perandorinë osmane drejtohej nga prijësit lokalë në krahinat malore dhe nga bejlerët nëpër qytete. Sulltanati ishte i bindur se nuk ishte e lehtë t’i nënshtroje shqiptarët me anë të Tanzimatit. Çështjet gjyqësore i zgjidhnin vetë me anë të pleqësive të tyre, nizamë nuk kishin dëshirë të dërgonin. Taksat, revoltat dhe lufta e mallakastrjotëve po bëhej e pashmangshme. Rrapo Hekali ishte prijës krahinor që nuk ishte afër nga pushteti qendror osman edhe pse kishte titull osman. Është fakt se në vitet e kryengritjeve kundër tanzimatit familjet e njohura feudale ishin të kufizuara. Kështu kazaja e Delvinës, nga 32 përfaqësues kishte vetëm një ka titull “bej”: Abdyl bej Koka, nga një familje e njohur feudale e Delvinës; Kazaja e Vlorës nga 44 përfaqësues me tituj osmanë ishin vetëm 4 vetë; në Mallakastër, nga 12 vetë, vetëm Rrapo Hekali (Hasani) kishte një pronë, të blerë me paratë e fituara nga shërbimet ushtarake ndaj osmanëve, ku kishte marrë edhe titullin “aga”.

Besëlidhja e Sinjës dhe kapëdanët e kuvendeve

Gjatë zhvillimit të saj, Rrapo Hekali thirri kuvendin “Besëlidhja e Sinjës”, në të cilën mori pjesë paria e Mallakastrës dhe krahinës së lumit të Vlorës, kuvend i cili është përjetësuar si më poshtë: “Në Sinjë u mbledh ordhia/sec u mbledhë pleqësia./Pleqtë e Kuçit gjithë vanë/u mbush Sinja me nizamë/topat rrebeshirë vanë”. Komanda qendrore drejtohej nga Rrapo Hekali, i cili drejtonte edhe formacionet e kryengritjes popullore. Pas kësaj mbledhjeje Rrapo Hekali shkoi në fshatin e lindjes në Hekal dhe aty mbledhi popullin e fshatrave Aranitas, Klos, Kalenjë, Cakran. Mbledhja u pasua nga ajo e Powlës, ku u bë bashkimi dhe riorganizimi i luftëtarëve të trevës së Mallakastrës, Myzeqesë dhe lumit të Vlorës. Autoritetet osmane të Beratit vendosën që në kushtet e zgjerimit të kryengritjes ta likuidonin atë, duke dërguar trupat e tyre drejt Mallakastrës së Sipërme, ku ndodhej epiqendra kryesore e lëvizjes. Në fillim të zbatimit të reformave autoritetet osmane organizuan një mbledhje në Berat me gjithë parinë e krahinës së Mallakastrës, Vlorës e Labërisë. Mbledhja synonte për t’i bindur ata që të pranonin Reformat e Tanzimatit të shpallura me shumë bujë nga Porta e Lartë e Sulltanit. Në fakt ndryshe nga sa kishin parashikuar autoritetet osmane, krerët e kazasë së Mallakastrës, Vlorës dhe Labërisë jo vetëm që nuk i pranuan Reformat e Tanzimatit, por paralajmëruan që të mos tentonte të



dërgonte njerëz për të mbledhur taksat dhe detyrimet, si dhe nizamë në këto krahina. Në këtë kuvend morën pjesë Kapedanët Rrapo Hekali, Sulo e Muço Zeneli nga Greshica, Dervish Aliu, Tartar Memush Ruka, Hajdër Kanina, Zenel Xhafo Aranitasi, Orhan Bardhaj, Shaban Peshtani, Lulo Duraj dhe Yzeir Mahmutaj nga Kalenja, Luman Elmazi nga Drizari, Yzeir Cakrani, Hyso Qesarati, Dule Mato, Sadik Luftinja, dhe Sulejman Çelo Toçi, si dhe kapedanë të tjerë të Mallakastrës, të lumit të Vlorës dhe të krejt Labërisë, të cilët në përfundim të mbledhjes i paralajmëruan edhe një herë osmanët që të mos shkelnin në këto krahina.

Mallakastra - zemra e kryengritjes mbarë popullore

Mallakastra bënte pjesë në Sanxhakun e Beratit. Mallakastra ka shkruar histori edhe përpara Rrapo Hekalit dhe tre Besëlidhjeve. Vetë emrin “Mallakastër” mendohet se e ka marrë nga romakët e Jul Çezarit nga fjalët latine “male” dhe “castre”/(kala e keqe). Sanxhaktari Hysen Pashë Vrioni, ishte treguar ndër administratorët më të zellshëm në zbatimin e Reformave të Tanzimatit. Në verën e 1847-s mallakastriotët u mblodhën në qendër të Hekalit, ku Rrapo Hekali bëri organizimin kundër pabesisë vrionase të asaj periudhe. Vrionasit me ushtarët e tyre dolën nga Berati dhe u përpoqën të depërtonin në Mallakastrën kryengritëse, por fakt historik është se, në afërsi të fshatit Greshicë u pritën nga mallakastriotët të cilët zunë rob Isuf bej Vrionin dhe të vëllanë, të cilëve hakmarrja popullore bëri që të vareshin në Sinjë, në një fshat në këmbë të malit të Shpiragut. Më tej ushtria mallakastriote e Rrapo Hekalit, që arriti deri në 1000 luftëtarë, rrethoi Beratin dhe arriti të marrë lagjet e jashtme të qytetit deri në dyert e kalasë. Por në të njëjtën kohë e njëjta pamje po ndodhte edhe në rrethinat e Gjirokastrës, ku Zenel Gjoleka me kurveleshasit kishin rrethuar kalanë. Si të gjitha kryengritjet edhe kjo ishte e destinuar të dështonte përballë mobilizimit të Portës së Lartë, ku sultani kishte dërguar në Shqipëri

kryekomandantin e forcave Ballkanike Mehmet Reshit Pashën, i njohur për egërsinë e tij. Faktet flasin se me gjithë paralajmërimin në mbledhjen e Sinjës në Berat, administrata osmane dërgonte në Greshicë një taksambledhës të quajtur Latif Salanji me dy zaptije (ushtarë), të cilët kryengritësit i vranë pranë fshatit Greshicë, duke u përcjellë mesazhin osmanëve se kërkonin të jetonin të lirë. Kundërpërgjigjia e osmanëve pas vrasjes në Greshicë ishte një operacion në shkallë të gjerë me dy taborë të armatosur me armët më moderne të kohës, topa, havana, karabina të reja me bajoneta, me kavaleri dhe këmbësori të rregullt, të stërvitur për luftë sipas modeleve të fundit të ushtrive europiane. Osmanët bënë që lajmi të përhapej në gjithë zonën, duke kaluar gojë më gojë e fshat më fshat, se ata ishin nisur në drejtim të Mallakastrës, që shigjetonin kryesisht Sinjën, si dhe krye kapedanin mallakastriot Rrapo Hekali. Në qafën e Sinjës ushtria osmane u nda në dy pjesë, duke marrë drejtimin për në Aranitas dhe në drejtim të Greshicës. Në faqet e dokumentuara të historisë shqiptare përmendet për rolin e tij edhe komandant Sulo Zeneli si organizator i çetës së Greshicës, ku luftëtarët megjithëse të armatosur keq deri edhe me shurqe e sëpata, ishin të vendosur për të luftuar deri në pikën e fundit të gjakut, për të mbrojtur vendin.

Kërkesa osmane: “Çdo shtëpi nga një dash dhe nga një vashë”

Përgjigjia shqiptare: “1000 osmanë të vrarë, 300 dëshmorë shqiptarë”

Populli i Greshicës dërgoi një përfaqësi në çadrat e garnizonit të komandës së ushtrisë osmane të kryesuar nga Sheh Hyseni, për të marrë vesh misionin e tyre. Sheh Hyseni ishte për kohën një nga burrat më të mençur në të gjithë krahinën, i shquar për urti e maturi dhe për fjalën me peshë. Bisedimet u zhvilluan në një klimë shumë të acaruar dhe krerët e ushtrisë osmane i kërcënuan greshiciotët se do të marrin për çdo shtëpi “nga një dash dhe nga një vashë”. Në këtë kohë sheh Hyseni me mençurinë shqiptare

iu përgjigj me ironi: “Po, në mëngjes do t’i kenë gati këto që kërkonin, edhe deshtë edhe vashat”. Përballja kryesore midis forcave osmane të drejtuar nga komandanti i tyre Hysen Pashë Vrioni dhe kryengritësve të drejtuar nga Rrapo Hekali, u bë pikërisht në korrik 1847 në fshatin Greshicë. Pozicionet midis dy forcave kundërshtuese kalonin në një front rreth 3-4 km. Forcat osmane kishin një efektiv prej 2 400 ushtarësh, kurse forcat e kryengritësve arrinin në 800 veta. Luftimet në Greshicë zgjatën 3 ditë e 3 net dhe përfunduan me thyerjen e ushtrisë osmane, ku pati rreth 1000 osmanlinj të vrarë; ndërsa nga forcat kryengritëse 300 luftëtarë të vrarë, nga të cilët edhe 60 djem smokthiniotë, që të gjithë dëshmorë, ndoshta të paevidentuar, që kanë marrë emrin e epokës luftarake të Rrapo Hekalit. Figura e kapedan Rrapos paraqitet në vargjet e popullit: “Ra tërmeti u tund mali,/thonë vjen Rrapo Hekali,/Ç’janë ata që shkojnë zallit/Trimat e Rrapo Hekalit/Sokëllin Rrapo Hekali/Sokëllin sa tundet mali,/Tundet mali, tundet fusha/Rrapua me dyqind mushka.../As u trembe as u tute/Plumbat të binin mbi supe... dhe finalizohet: “Pse lufton a derëzi,/As për mua dhe për ti,/Por për gjithë Shqipëri”.

Kapedanët nuk i mposht as thika, as plumbi, as helmi

Pas luftimeve të pabarabarta kryengritësit e braktisën qytetin e Beratit dhe u shpërndanë për të vazhduar qëndresën të organizuar në çeta. U shquan luftëtarët e fshatit Dukatit nën udhëheqjen e Dervish Aliut, Zenel Xhafos, Orhan Bardhos etj. Kjo kryengritje dështoi si pasojë e tradhëtisë së brendshme të disa bejlereve. Lufta u ndërpre për disa ditë dhe kështu u dha kohë osmanëve të riorganizoheshin dhe të mbylleshin në kalanë e Beratit. Me shtypjen përfundimtare të kryengritjes së vitit 1847 në Shqipërinë e Jugut autoritetet osmane mundën të arrestonin Rrapo Hekalin me të vëllanë Hamit Hasani, Tahir Çaparin dhe luftëtarë të tjerë, të cilët i burgosën dhe i internuan deri në

Anadoll. Pasi e burgosën në burgun e Manastirit atë e ekzekutuan me helmim kapedanin e Mallakastrës Rrapo Hekalin, në mesnatën e 31 Dhjetorit 1847. Versioni zyrtar osman për vdekjen e tij ishte se ajo u shkaktua nga sëmundja e tifos, por gojëdhëna popullore është dokument i pagabueshëm kur thotë se: “Osmanët helmuan kapedanin popullor të Hekalit të Mallakastrës, memorialin kombëtar të shqiptarizimës”. Rrapo Hekali, me karakterin burrëror, me shpirtin e fuqishëm e të pamposhtur atdhetar, me mbrojtjen e vegjëlisë nga shtypja e mjerimi, me urrejtjen e pashterur kundër pushtuesve turq, u bë frymëzim brezash për liri e pavarësi kombëtare. Pas shtypjes së kryengritjes, Porta e Lartë bëri reprezalje të rënda në Mallakastër, ku u përdor gjerësisht terrori mbi popullsinë me ekspedita ndëshkuese gjatë dimrit 1847-1848, duke djegur fshatra te tillë si, Greshica, Klosi e Fratari, megjithëse kryengritjet dhe revoltat anti-osmane nuk u shuan asnjëherë vatrat e qëndresës, gjatë gjithë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Megjithëse në fakt qeveria osmane ndërmori atëherë zbatimin e sistemit të ri tanzimatist në Shqipërinë e Jugut. Me amnistinë e vendosur më vonë nga osmanët fshatarët iu rikthyen jetës së përditshme, megjithëse vendi ishte rrënuar dhe në Mallakastrën e sipërme gjithçka duhej të niste përsëri nga e para. Disa vite më vonë Porta e Lartë përveç reformave të lëna përgjysmë realizoi edhe reformën administrative. Treva e Fierit u fut në vilajetin e Janinës.

Myzeqeja dhe Mallakastra në këtë vilajet gëzonin statusin e Nahijeve, status që qëndroi deri në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në 1912. Nahija administrohej nga Mydiri. Pranë tij vepronte Këshilli administrativ konsultativ (Mexhlis-i idare). Mexhlisi diskutonte të gjitha çështjet administrative të Nahijes/krahinës.

Gjëmimet e kuvendeve dhe 400 epopeve të historisë së trimërive
Në Qafën e Sinjës, pasi kalon Gjurmën e Mushkës, ndjen erën e shekujve sepse këtej kalonte rruga e udhëkryqeve

nga Vlora, Ballshi, Ura e Thellë për Berat, Voskopojë, këtej kalonin rrugët nga perëndimi në lindje, nga jugu në veri, nga Tepelena nëpër kurrize kodrash drejt Myzeqesë, nga hani i madh, si vendqëndrim, pushim për karvanë e tregtarë që vinin nga Vlora, nga Voskopoja, Berati. Por mbi të gjitha në këtë pikë janë refuzuar Osmanët në vitet 1640, 1667, 1676, 1740, 1830, 1835, 1840 herë me mosdhënie taksash e nizamësh, herë me kryengritje. Këtu u luajt një nga skenat më dramatike të kryengritjeve anti-osmane në mes të shekullit XVIII. Në Sinjë është shkruar me gjak epopeja e vitit 1847, ku Rrapo Hekali në Sinjë mbledh parinë e thjeshtë nga Mallakastra, Vlora etj. Sinja do ishte përsëri vend i pushkës dhe kuvendit, ku më 22 korrik 1912 u mblodhën udhëheqësit kryengritës të Shqipërisë së Jugut që vendosën më 23 korrik 1912 “Memorandumin e Sinjës”, një prelud i Pavarësisë. 20 km në perëndim të Beratit, 800 metra mbi nivelin e detit, ku nis mali i Shpiragut në Qafën e Sinjës, në fshatin me katër çezma, katër dyqane, katër sheshe, katër mullinj, katër rrugë dhe me katërqind epope trimërie e heroizmi.

Qytetërimi që lindi kapedanë të shquar të historisë shqiptare

Kapedani popullor Rrapo Hekali i përket origjinës së qytetërimit të bylinëve, që ishte themeluar rreth vitit 370 para Krishtit, si kryeqendra e Koinonit ose lidhjes së Bylinëve, një republikë e vogël mbi bregun e djathtë të Vjosës. Të dhënat arkeologjike e historike flasin se në 863 Khani i bullgarëve, Borisi, u mund nga ushtritë e Bizantit në këto treva dhe një nga pikat e “Traktatit të paqes” ishte që ai dhe bullgarët duhej të pagëzoheshin si të krishterë. Që atëherë është bërë e njohur kisha e madhe, e “Fjetjes së Hyjlindëses”. Vetë Shën Klementi i Ohrit, një nga shenjtorët më të rëndësishëm të kohës, mori pjesë më 893, në përvënjen dhe pagëzimin e bullgarëve. Këtu përmendet epitafi i famshëm: “Epitafi i Gllavencës” i qëndisur në flori prej Gjergj Arianitit dhe Kristo Gllavarit në vitin 1373. Trualli ku lindi Rrapo Hekali kishte një të shkuar të madhe dhe shekuj të shkëlqyer qytetërimi. Bylisi kishte teatër, stadium, disa tempuj, mone dhën e vet. Në 229 para Krishtit romakët pushtuan Apoloninë, por Bylinët ruajtën paqen me Romën. Në vitin 168 para Krishtit bylinët u lidhën me Perseun e Maqedonisë kundër Romës. Paul Emili, konsulli ndëshkues romak, pasi shkatërroi 70 qytete të Epirit rrafshoi edhe disa kështjella në Mallakastrën e sotme, që është një ndër pjesët më tragjike të historisë së kësaj treve. Megjithëse Koinoni i bylinëve u shpërbë, Bylisi mbeti autonom dhe nuk u prek dhe në vitin 48 para Krishtit Bylisi i hapi portat Jul Çezarit në luftën kundër Pompeut. Më vonë Bylisi u shndërrua në koloni romake dhe aty u vendos qendra e peshkopatës që dikur ishte në Apoloni. Rreth viti 586 sllavët dogjën, plaçkitën e shkatërruan qytetin, por mallakastriotët në rrugën e gjatë e të mundimshme të pushtimeve janë ringritur gjithmonë aq herë sa janë rrëzuar, kanë ditur të ringrenë jetën dhe të lindin kapedanë e atdhetarë të flaktë si Rrapo Hekali dhe qindra të tjerë.

Ti je forca që nderon kombin!

Akademia e Forcave të Armatosura për të tretin vit radhazi, hap dyert për maturantët shqiptarë.

AFA ofron programe prestigjioze studimi, lehtësira si asnjë institucion tjetër arsimor si dhe punësim të sigurt pas përfundimit të studimeve.

AFA, një mundësi fantastike për arsimim dhe karrierë!



REKRUTIM
FORCAT E ARMATOSURA
TË SHQIPËRISË

3 ARSYE PSE DUHET TË ZGJEDHIM AKADEMINË E FORCAVE TË ARMATOSURA

PAGESË MUJORE NDIHMËSE PËR ÇDO STUDENT
PËR TË GJITHË PERIUDHËN E STUDIMIT



AKOMODIM DHE USHQIM FALAS
PËR 3 VITET E STUDIMIT NË AKADEMI



TARIFË STUDIMI
0 LEKË NË VIT



REGJISTROHU TANI PËRMES PORTALIT U-ALBANIA
www.mod.gov.al